

JRC: RAPORT SHKENCOR PËR POLITIKA

Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale të Eduktorëve

DigCompEdu

Christine Redecker (Autore)
Yves Punie (Redaktor)





**Co-funded by
the European Union**

Ky përkthim është mbështetur nga projekti i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, tkaedite.eu, i udhëhequr nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Edukimit, me akronim: UP, me titullin “Transforming the Kosovo and Albanian Education System by Introducing Digital Technology in Teacher Education”, dhe me Projekt ID: I01082862.



RAPORT SHKENCOR PËR POLITIKA

NGA

QENDRA E PËRBASHKËT KËRKIMORE (JRC)

Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale të Edukatorëve

DigCompEdu

Ky publikim është një Raport Shkencor për Politika i përgatitur nga Qendra e Përbashkët Kërkimore (Joint Research Centre, shkurt JRC), që është shërbimi shkencor dhe njohurive i Komisionit Evropian. Qëllimi i tij është të ofrojë mbështetje shkencore të bazuar në dëshmi për procesin e hartimit të politikave në nivel evropian. Përmbajtja shkencore e paraqitur në këtë raport nuk përfaqëson patjetër qëndrim politikash të Komisionit Evropian. As Komisioni Evropian dhe asnjë person që vepron në emër të tij, nuk mban përgjegjësi për mënyrën se si mund të përdoret ky publikim.

Informacione kontakti:

Adresa: Edificio Expo, C/ Inca Garcilaso 3, E-41092 Seville (Spain) Email:
yves.punie@ec.europa.eu
Tel.: +34 954 488 318

JRC Science Hub

<https://ec.europa.eu/jrc>

JRC107466 EUR

28775 EN

PDF	ISBN 978-92-79-73494-6	ISSN 1831-9424	doi:10.2760/159770
Print	ISBN 978-92-79-73718-3	ISSN 1018-5593	doi:10.2760/178382

Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2017
© European Union, 2017

Lejohet ripërdorimi, me kusht që të citohet burimi. Politika e ripërdorimit të dokumenteve të Komisionit Evropian rregullohet nga Vendimi 2011/833/BE (OJ L 330, 14.12.2011, f. 39).
Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive apo materialeve që nuk mbulohen nga të drejtat e autorit sipas legjislacionit të BE-së, duhet të kërkohet leje drejtpërdrejt nga mbajtësit e këtyre të drejtave.

Si të citohet ky raport: Redecker, C. European Framework for the Digital Competence of Educators: DigCompEdu. Punie, Y. (ed). EUR 28775 EN. Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2017, ISBN 978-92-79-73494-6, doi:10.2760/159770, JRC107466

Redaktimi dhe korrektimi gjuhësor: Patricia Farrer Dizajni dhe faqesja:
Prodigioso Volcán SL

Koordinimi redaktorial: Emiliano Bruno

Të gjitha imazhet © European Union 2017

Titulli: European Framework for the Digital Competence of Educators: DigCompEdu

Abstrakt

Ndërsa edukatorët përballen me kërkesa që ndryshojnë me shpejtësi, ata kanë nevojë për një sërë gjithnjë e më të gjerë të kompetencave, të cilat janë më të sofistikuar se më parë. Veçanërisht, përhapja e pajisjeve digjitale dhe detyrimi për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë kompetencë digjitale kërkon që vetë edukatorët të zhvillojnë nivelin e kompetencës digjitale.

Në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar janë hartuar plot korniza, mjete për vetëvlerësim dhe programe trajnimi për të përshkruar dimensionet e ndryshme të kompetencës digjitale për edukatorët, për t'u ndihmuar atyre të vlerësojnë aftësitë e veta, për të identifikuar nevojat për trajnim dhe për të ofruar trajnime të synuara. Bazuar në analizën dhe krahasimin e këtyre instrumenteve, ky raport paraqet një Kornizë Evropiane të përbashkët për Kompetencën Digjitale të Edukatorëve (e ashtuquajtur DigCompEdu). DigCompEdu është një kornizë shkencërisht e qëndrueshme që ndihmon në udhëzimin e politikave dhe mund të përshtatet drejtpërdrejt për implementimin e mjeteve dhe programeve të trajnimit në nivel rajonal dhe kombëtar. Gjithashtu, ajo ofron një gjuhë dhe qasje të përbashkët që do të nxisë dialogun dhe shkëmbimin e praktikave më të mira përtej kufijve.

Korniza DigCompEdu është krijuar për edukatorët në të gjitha nivelet e arsimit, nga ai parashkollor deri te arsimi i lartë dhe arsimi i të rriturve, duke përfshirë arsimin e përgjithshëm dhe atë profesional, arsimin e përshtatur për nevoja të veçanta dhe kontekstet e mësimi joformal. Qëllimi i saj është të ofrojë një kuadër referues të përgjithshëm për hartuesit e modeleve të Kompetencës Digjitale, përkatësisht Shtetet Anëtare, autoritetet qeveritare në nivel rajonal, agjencitë relevante kombëtare dhe rajonale, vetë organizatat arsimore, si dhe ofruesit e aftësimi profesional në sektorin publik dhe privat.

Publikimi është shtypur në Spanjë

Përmbajtja

Parathënie	06
Përmbledhje ekzekutive	08
Falënderime	10
Hyrje	12
Korniza DigCompEdu në pika të shkurtra	14
Korniza DigCompEdu e shpjeguar	18
01 Angazhimi profesional	19
02 Resurset digjitale	20
03 Mësimdhënia dhe mësimnxënia	20
04 Vlerësimi	21
05 Fuqizimi i nxënësve	22
06 Lehtësimi i zhvillimit të kompetencës digjitale të nxënësve	23
07 Pasqyrë	24
Korniza DigCompEdu në hollësi	26
01 Angazhimi profesional	32
02 Resurset digjitale	42
03 Mësimdhënia dhe mësimnxënia	50
04 Vlerësimi	60
05 Fuqizimi i nxënësve	68
06 Lehtësimi i zhvillimit të kompetencës digjitale të nxënësve	76
Fjalorth terminologjik	88
Lista e figurave	93
Lista e tabelave	93



A



Parathënie



Ky studim paraqet një kornizë për zhvillimin e kompetencës digjitale të edukatorëve në Evropë. Ai synon të ndihmojë Shtetet Anëtare në përpjekjet e tyre për të promovuar kompetencën digjitale të qytetarëve dhe për të nxitur novacionin në arsim. Korniza ka për qëllim të mbështesë përpjekjet kombëtare, rajonale dhe lokale për zhvillimin e kompetencës digjitale të edukatorëve, duke ofruar një kuadër referues të përbashkët, me një gjuhë dhe logjikë të përbashkët.

Kërkimet e Qendrës së Përbashkët Kërkimore (JRC) mbi Mësimin dhe Aftësitë për Epokën Digjitale filloi në vitin 2005. Qëllimi ishte të ofrohej mbështetje e bazuar në dëshmi për hartimin e politikave të Komisionit Evropian, me synimin që të shfrytëzohej potenciali i teknologjive digjitale për të nxitur novacionin në praktikën e arsimit dhe aftësimin; për të përmirësuar qasjen në mësim gjatë gjithë jetës; si dhe për të mundësuar përvetësimin e aftësive dhe kompetencave të reja (digjitale) të nevojshme për punësim, zhvillim personal dhe përfshirje sociale. Janë ndërmarrë më shumë se 20 studime madhore mbi këto çështje, duke rezultuar në mbi 120 publikime të ndryshme.

Punimet e fundit mbi zhvillimin e kapaciteteve për transformimin digjital të arsimit dhe mësimin, dhe për kërkesat në ndryshim për aftësi dhe kompetenca, janë përqendruar në hartimin e kornizave të kompetencës digjitale për qytetarët (DigComp), organizatat arsimore (DigCompOrg) dhe konsumatorët (DigCompConsumers). Në vitin 2016, u publikua gjithashtu korniza për hapjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë (OpenEdu), së bashku me kornizën e kompetencës për sipërmarrësi (EntreComp). Disa nga këto korniza shoqërohen edhe me instrumente (vetë-)vlerësimi. Janë kryer kërkime shtesë mbi Analitikën e Mësimin (Learning Analytics), Kurset e Hapura Masive Online (Massive Open Online Courses, shkurt MOOCs, përfshirë MOOCKnowledge dhe MOOCs4Inclusion), Mendimin Kompjuterik (Computhink) dhe politikën për integrimin dhe përdorimin novator të teknologjive digjitale në arsim (DigEduPol). Po ashtu, është në zhvillim një studim mbi përdorimin e teknologjisë blockchain në arsim.

Informacione të mëtejshme mbi këto studime mund të gjenden në qendrën shkencore të JRC (Science hub): <https://ec.europa.eu/jrc/en/research-topic/learning-and-skills>.

Yves Punie

Zëvendës Drejtues i
Njësisë DG JRC Njësia e Kapitalit Njerëzor dhe
Punësimit
Komisioni Evropian

Përmbledhje ekzekutive

Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale të Edukatorëve (DigCompEdu) i përgjigjet nevojës në rritje të shumë Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, që edukatorët të zotërojnë një sërë kompetencash digjitale specifike për profesionin e tyre, në mënyrë që të mund të shfrytëzojnë potencialin e teknologjive digjitale për të sjellë përmirësime dhe novacion në arsim.




FIGURA 1: KORNIZA DIGCOMPEDU



Korniza DigCompEdu synon të kapë dhe përshkruajë këto kompetenca digjitale specifike të edukatorëve, duke propozuar 22 kompetenca elementare të organizuara në 6 fusha (Figura 1): Fusha 1 është e orientuar drejt mjedisit profesional më të gjerë, duke përfshirë përdorimin e teknologjive digjitale nga edukatorët në ndërveprimet profesionale me kolegët, nxënësit, prindërit dhe palët e tjera të interesuara, si dhe në zhvillimin e tyre profesional individual dhe për të mirën kolektive të organizatës. Fusha 2 shqyrton kompetencat e nevojshme për përdorimin, krijimin dhe shpërndarjen e resurseve digjitale për të nxënë në mënyrë efektive dhe me përgjegjësi. Fusha 3 i kushtohet menaxhimit dhe orkestrimit të përdorimit të teknologjive digjitale në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Fusha 4 trajton përdorimin e strategjive digjitale për përmirësimin e procesit të vlerësimit. Fusha 5 fokusohet te potenciali i teknologjive digjitale për strategji të mësimdhënies dhe mësimnxënies të përqendruara te nxënësi. Fusha 6 detajon kompetencat pedagogjike specifike të nevojshme për të lehtësuar zhvillimin e kompetencës digjitale të nxënësve. Për secilën kompetencë është dhënë një titull dhe një përshkrim i shkurtër, të cilët shërbejnë si pikë referimi kryesore (Tabela 7, f. 24).

Korniza gjithashtu propozon një model progresioni për të ndihmuar edukatorët të vlerësojnë dhe zhvillojnë kompetencën e tyre digjitale. Ajo përshkruan gjashtë etapa të ndryshme përmes të cilave zakonisht zhvillohet kompetenca digjitale e një edukatori, me qëllim që t'i ndihmojë edukatorët të identifikojnë dhe të vendosin hapat konkretë që duhet të ndërmarrin për të forcuar kompetencën e tyre në etapën

ku ndodhen aktualisht. Në dy etapat e para, Fillestar/Newcomer (A1) dhe Eksplorues/Explorer (A2), edukatorët përvetësojnë informacione të reja dhe zhvillojnë praktika digjitale themelore; në dy etapat pasuese, Integruer/Integrator (B1) dhe Ekspert/Expert (B2), ata aplikojnë, zgjerojnë më tej dhe strukturojnë praktikatat e tyre digjitale; ndërsa në etapat më të larta, Udhëheqës/Leader (C1) dhe Pionier/Pioneer (C2), ata përcjellin njohuritë e tyre, japin kritika konstruktive të praktikave ekzistuese dhe zhvillojnë praktika të reja.

Korniza DigCompEdu përmbledh përpjekjet kombëtare dhe rajonale për të pasqyruar kompetencat digjitale të edukatorëve. Qëllimi i saj është të ofrojë një kuadër referues të përgjithshëm për hartuesit e modeleve të Kompetencës Digjitale, përkatësisht Shtetet Anëtare, autoritetet qeveritare në nivel rajonal, agjencitë relevante kombëtare dhe rajonale, vetë organizatat arsimore, si dhe ofruesit e aftësimit profesional në sektorin publik dhe privat. Ajo është krijuar për edukatorët në të gjitha nivelet e arsimit, nga ai parashkollor deri te arsimi i lartë dhe arsimi i të rriturve, duke përfshirë arsimin e përgjithshëm dhe atë profesional, arsimin e përshtatur për nevoja të veçanta dhe kontekstet e mësimi joformal. Autorët ftojnë dhe inkurajojnë përdoruesit të përshtatin dhe modifikojnë kornizën sipas kontekstit dhe qëllimit specifik.

Korniza bazohet në punën e kryer nga Qendra e Përbashkët Kërkimore (JRC) e Komisionit Evropian, në emër të Drejtorisë së Përgjithshme për Arsim, Rini, Sport dhe Kulturë (DG EAC).

Falënderime



Korniza DigCompEdu është rezultat i një përpjekjeje bashkëpunuese të shumë individëve që kontribuan në formësimin dhe përsosjen e saj në etapa të ndryshme të zhvillimit. Dëshirojmë t'u shprehim mirënjohjen tonë të gjithëve.

Por ne nuk i njohim me emër të gjithë ata që u kemi borxh t'i falënderojmë. Së këndejmi, duhet të falënderojmë mbi 100 mësime të mëdha që morën pjesë në një nga tre sesionet e posaçme të punëtorëve të mbajtura gjatë Konferencës eTwinning në Athinë, në tetor të vitit 2016. Ju e keni vënë propozimin tonë fillestar në një provë të botës reale, gjë që na ndihmoi ta riformësojmë atë në mënyrë që t'i përshtatet më mirë nevojave të edukatorëve. Gjithashtu, dëshirojmë të falënderojmë 72 pjesëmarrësit në konsultimet online me palët e interesuara. Bazuar në kontributin dhe sugjerimet tuaja, kemi arritur të hartojmë një version shumë më të qëndrueshëm dhe më të qëlluar të kornizës.

Grupi më i madh i ndihmësve, të cilët i njohim me emër dhe që kanë qenë vendimtarë në formësimin e kornizës, është grupi i ekspertëve evropianë që morën pjesë në punëtorinë e ekspertëve DigCompEdu. Ekspertiza juaj na ndihmoi të rristrukturojmë dhe riformësojmë kompetencat dhe fushat e kompetencës, duke siguruar koherencë dhe përputhshmëri të përgjithshme. Ju falënderojmë për diskutimet e gjalla që zhvilluam dhe për zgjidhjet e zgjuara që dolën prej tyre: Igor Balaban, Universiteti i Zagrebit, Kroaci; Anja Balanskat, European Schoolnet (EUN); Helen Beetham, Mbretëria e Bashkuar; Jeroen Bottema, Universiteti i Hollandës, Vendet e Ulëta; Vincent Carabott, Ministria e Arsimit dhe Punësimit, Maltë; Maria Jesús García, Ministria e Arsimit, Spanjë; Michael Hallissy, H2 Learning, Irlandë; Marijana Kelentric, Qendra për TIK në Arsim, Norvegji; Katrin Kiilaspää, Fondacioni i Teknologjisë së Informacionit për Arsim (HITSA), Estoni;



Seamus Knox, Ministria e Arsimit, Irlandë; Alvida Lozdienė, Qendra e Zhvillimit të Arsimit, Lituani; Margarida Lucas, CIDTFF, Universiteti i Aveiros, Portugali; Iain Mac Labhrainn (MacLaren), Universiteti Kombëtar i Irlandës, Galuej, Irlandë; Mario Mäeots, Universiteti i Tartut, Estoni; Frank Mockler, Fondacioni ECDL; Lise Møller, Kolegji Universitar i Kopenhagës (UCC), Danimarkë; Christina Papazisi, Ministria e Arsimit, Greqi; Bram Pynoo, Vrije Universiteit Brussel (VUB), Belgjikë; Daniela Ruzickova, Instituti Kombëtar për Arsim, Qendra e Këshillimit Arsimor dhe Qendra për Edukimin e Vazhdueshëm të Mësimdhënësve, Republika Çeke; Joao Sousa, Ministria e Arsimit, Portugali; Jens Tiburski, Instituti i Arsimit të Saksonisë, Gjermani; Jarmo Viteli, Universiteti i Tampere, Finlandë; Stephan Waba, Ministria e Arsimit, Austri; Marta Zuvic, Universiteti i Rijekës, Kroaci.

I jemi veçanërisht mirënjohës grupit të vogël të ekspertëve që u ofruan vullnetarisht të sfidojnë, rishikojnë dhe përsosin disa nga detajet më të ndërlikuara të kornizës, duke ofruar ekspertizën e tyre për ta përmirësuar atë në mënyrë të qenësishme: Josie Fraser, Wikimedia, Mbretëria e Bashkuar; Regina Obexer, MCI Management Center Innsbruck, Austri; Cristóbal Suárez-Guerrero, Universitat de València, Spanjë.

Gjithashtu, dëshirojmë të falënderojmë të gjithë ata që e pasuruan punën me komentet dhe vërejtjet e tyre: Alessandro Brolpito, ETF, Torino, Itali; Martina Emke, Servicestelle Offene Hochschule Niedersachsen gGmbH, Gjermani; Radovan Krajnc, Instituti Kombëtar i Arsimit, Slloveni; Nives Kreuh, Instituti Kombëtar i Arsimit, Slloveni; Niki Lambropoulos, Greqi; Carlos Marcelo, Universidad de Sevilla, Spanjë; Stephan Müller, Universiteti Johannes Gutenberg Mainz, Gjermani; Jennifer Tiede, Universiteti i Würzburg, Gjermani; Nicola Brocca, Shkolla e Edukimit Heidelberg, Gjermani.

Një falënderim i posaçëm u drejtohet anëtarëve të Grupit të Punës për Aftësi dhe Kompetenca Digjitale, në kuadër të European Training 2020 (ET 2020 DSC). Nga këndvështrimet e ndryshme kombëtare, ju na ndihmuat të kuptojmë se si të përsosim kornizën për të siguruar përshtatshmërinë e saj universale.

U jemi thellësisht mirënjohës kolegëve tanë në Drejtorinë e Përgjithshme për Arsim, Rini, Sport dhe Kulturë (DG EAC), të cilët kanë shoqëruar dhe mbështetur zhvillimin e kornizës në të gjitha etapat e saj: Georgi Dimitrov, Hannah Grainger Clemson, Deirdre Hodson, Konstantin Scheller dhe Nicolai Skafte. Gjithashtu, në kuadër të JRC, kemi marrë mbështetje të rëndësishme në aspektin logjistik dhe administrativ nga Maria Dolores Romero Lopez, Emiliano Bruno, Patricia Farrer dhe Tanja Acuna. Nga ana shkencore, dëshirojmë të falënderojmë ekipin përgjegjës të "TIK për Mësim dhe Aftësi" (*ICT for Learning and Skills*) për komentet dhe angazhimin e tyre të çmuar: Margherita Bacigalupo, Stephanie Carretero, Andreia Inamorato dos Santos, Panagiotis Kampylis, Margarida Rodrigues dhe Riina Vuorikari.

Fare në fund, dëshirojmë të falënderojmë Rafaela Campani dhe Lupe Cruz nga Prodigioso Volcán SL. Grafikët dhe mjetet vizuale që keni krijuar, i japin këtij raporti veçanti dhe atraktivitet të posaçëm.



Hyrje

Shtrirja e gjerë e teknologjive digjitale ka ndryshuar në mënyrë të thellë pothuajse të gjitha aspektet e jetës sonë: mënyrën se si komunikojmë, mënyrën se si punojmë, mënyrën se si e kalojmë kohën e lirë, mënyrën se si e organizojmë jetën tonë dhe mënyrën se si e gjejmë dijen dhe informacionin. Teknologjitë digjitale kanë ndryshuar mënyrën se si mendojmë dhe mënyrën se si sillemi. Fëmijët dhe të rinjtë po rriten në një botë ku teknologjitë digjitale janë të pranishme kudo. Ata nuk njohin një realitet tjetër, madje as nuk mund ta imagjinojnë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se janë të pajisur në mënyrë të natyrshme me aftësitë e nevojshme për t'i përdorur këto teknologji në mënyrë efektive dhe të ndërgjegjshme.

Politikat kombëtare dhe evropiane e njohin nevojën për t'i pajisur të gjithë qytetarët me kompetencat e nevojshme për të përdorur teknologjitë digjitale në mënyrë kritike dhe kreative. Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale (DigComp), e cila është azhurnuar në vitin 2016/17, i përgjigjet kësaj nevoje duke ofruar një strukturë që u mundëson qytetarëve evropianë të kuptojnë më mirë se çfarë do të thotë të jesh kompetent në aspektin digjital, si dhe të vlerësojnë e zhvillojnë më tej kompetencën e tyre digjitale.

Për nxënësit dhe studentët në arsimin e detyrueshëm, ekziston një gamë e gjerë iniciativash në nivel evropian, kombëtar dhe rajonal, që ofron udhëzime dhe këshilla se si të mundësohet zhvillimi i kompetencës digjitale te të rinjtë, shpesh me theks te aftësitë kritike dhe ajo që njihet si qytetaria digjitale. Në shumicën e Shteteve Anëtare të BE-së, janë hartuar ose janë në proces hartimi kurrikulat përkatëse, për të siguruar që brezi i ri të jetë i aftë të marrë pjesë në mënyrë kreative, kritike dhe produktive në një shoqëri digjitale.

Në nivel ndërkombëtar, evropian, kombëtar dhe rajonal, ekziston një interes i konsiderueshëm për t'i pajisur mësimmësuesit me kompetencat e nevojshme për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e teknologjive digjitale në përmirësimin e mësimmësuesisë dhe mësimmësisë, si dhe për t'i përgatitur siç duhet nxënësit për jetën dhe punën në një shoqëri digjitale. Shumë Shtete Anëtare të BE-së tashmë kanë hartuar ose janë në procesin e hartimit apo rishikimit të kornizave, instrumenteve të vetë-vlerësimit dhe programeve të trajnimit për të udhëzuar aftësimin e mësimmësuesve dhe zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional në këtë fushë.

Objektivi i kornizës DigCompEdu të propozuar në këtë raport, është të reflektojë mbi instrumentet ekzistuese për kompetencën digjitale të edukatorëve dhe t'i sintetizojë ato në një model koherent, i cili do t'u mundësonte edukatorëve në të gjitha nivelet e arsimit të vlerësojnë dhe të zhvillojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse kompetencën e tyre digjitale pedagogjike.

Korniza DigCompEdu nuk është menduar të zbehtë përpjekjet kombëtare, rajonale apo lokale për të pasqyruar kompetencën digjitale të edukatorëve. Përkundrazi, larmia e qasjeve në Shtete Anëtare të ndryshme kontribuon në një debat produktiv dhe të vazhdueshëm dhe kjo është e mirëseardhur. Qëllimi i kornizës është të ofrojë një bazë të përbashkët për këtë debat, me një gjuhë dhe logjikë të përbashkët si pikënisje për krijimin, krahasimin dhe diskutimin e instrumenteve të ndryshme për zhvillimin e kompetencës digjitale të edukatorëve, në nivel kombëtar, rajonal apo lokal.

Kështu, vlera e shtuar e kornizës DigCompEdu qëndron në faktin se ajo ofron:

- ♦ një bazë të qëndrueshme që mund të udhëzojë politikën në të gjitha nivelet;
- ♦ një model që u mundëson palëve të interesuara në nivel lokal të kalojnë shpejt në krijimin e një instrumenti konkret, të përshtatur me nevojat e veta, pa pasur nevojë të zhvillojnë një bazë konceptuale për këtë punë;
- ♦ një gjuhë dhe logjikë të përbashkët që mund të ndihmojë në diskutimin dhe shkëmbimin e praktikave të mira përtej kufijve;
- ♦ një pikë referimi për Shtetet Anëtare dhe palët e tjera të interesuara për të verifikuar plotësinë dhe qasjen e instrumenteve dhe kornizave të tyre ekzistuese dhe të ardhshme.

Korniza DigCompEdu është rezultat i një sërë diskutimesh dhe shqyrtimesh me ekspertë dhe praktikues, të bazuara në një rishikim fillestar të literaturës dhe në sintezën e instrumenteve ekzistuese në nivel lokal, kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar. Qëllimi i këtyre diskutimeve ishte arritja e konsensusit mbi fushat dhe elementet kryesore të kompetencës digjitale të edukatorëve, përcaktimi i elementeve qendrore dhe marginale, si dhe logjika e progresionit në kompetencën digjitale në secilën fushë.

Modeli i propozuar mund të kishte marrë një formë dhe një qasje tjetër. Ai nuk synon të minojë apo të vërë në dyshim vlefshmërinë dhe rëndësinë e modeleve të ngjashme që ndjekin qasje alternative. Përkundrazi, synimi është që kjo larmi të përqafohet si një mënyrë për të nxitur debatin mbi kërkesat vazhdimisht në ndryshim për kompetencën digjitale të edukatorëve.

Korniza bazohet në punën e kryer nga Qendra e Përbashkët Kërkimore (JRC) e Komisionit Evropian, në emër të Drejtorisë së Përgjithshme për Arsim, Rini, Sport dhe Kulturë (DG EAC).



Korniza DigCompEdu

në pika të shkurtra




FIGURA 2: KORNIZA DIGCOMPEDU: FUSHAT DHE FUSHËVEPRIMI

Edukatorët janë shëmbëlltyrë për brezat e ardhshëm. Prandaj, është e rëndësishme që ata të pajisen me kompetencën digjitale që u nevojitet të gjithë qytetarëve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në një shoqëri digjitale. Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Qytetarët (DigComp) i përcakton këto kompetenca. DigComp është shndërruar në një instrument të pranuar gjerësisht për matjen dhe certifikimin e Kompetencës Digjitale dhe është përdorur si bazë për aftësimin e mësimitdhënësve dhe zhvillimin e tyre profesional brenda dhe jashtë Evropës. Si qytetarë, edukatorët duhet të pajisen me këto kompetenca për të marrë pjesë në shoqëri, si në aspektin personal, ashtu edhe në atë profesional. Si model për brezat e ardhshëm, ata duhet të jenë në gjendje t'ua demonstrojnë qartë nxënësve kompetencën e tyre digjitale dhe t'ua transmetojnë atyre përdorimin kreativ dhe kritik të teknologjive digjitale.

Megjithatë, edukatorët nuk janë vetëm model për brezat e ardhshëm. Ata janë para së gjithash lehtësues të të nxënësve, ose më thjeshtë: mësimitdhënës. Si profesionistë të përkushtuar ndaj mësimitdhënies, atyre u nevojiten, përveç kompetencave të përgjithshme digjitale për jetën dhe punën, edhe kompetenca digjitale të veçanta për edukatorët, në mënyrë që të jenë në gjendje të përdorin me efektivitet teknologjitë digjitale për mësimitdhënie. Qëllimi i kornizës DigCompEdu është të përfshijë dhe të përshkruajë këto kompetenca digjitale të veçanta për edukatorët.

Korniza DigCompEdu dallon gjashtë fusha të ndryshme, në të cilat shprehet kompetenca digjitale e edukatorëve, me gjithsej 22 kompetenca (shih Figura 3, f. 16).




FIGURA 3: KORNIZA DIGCOMPEDU: KOMPETENCAT DHE NËRËLIDHJET E TYRE

Gjashtë fushat e DigCompEdu përqendrohen në aspekte të ndryshme të aktiviteteve profesionale të edukatorëve:

Fusha 1: Angazhimi profesional

Përdorimi i teknologjive digjitale për komunikim, bashkëpunim dhe zhvillim profesional.

Fusha 2: Resurset digjitale

Gjetja, krijimi dhe ndarja e resurseve digjitale.

Fusha 3: Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Menaxhimi dhe orkestrimi i përdorimit të teknologjive digjitale në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Fusha 4: Vlerësimi

Përdorimi i teknologjive dhe strategjive digjitale për të përmirësuar procesin e vlerësimit.

Fusha 5: Fuqizimi i nxënësve

Përdorimi i teknologjive digjitale për të rritur përfshirjen, personalizimin dhe angazhimin aktiv të nxënësve.

Fusha 6: Lehtësimi i zhvillimit të kompetencës digjitale të nxënësve

Mundësimi që nxënësit të përdorin teknologjitë digjitale në mënyrë kreative dhe me përgjegjësi për informim, komunikim, krijim përmbajtjeje, mirëqenie dhe zgjidhje problemesh.

Bërthama e kornizës DigCompEdu përcaktohet nga Fushat 2-5. Së bashku, këto fusha shpjegojnë kompetencën digjitale pedagogjike të edukatorëve, pra kompetencat digjitale që u nevojiten edukatorëve për të kultivuar strategji të efektshme, gjithëpërfshirëse dhe novatore për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Fushat 1, 2 dhe 3 janë të ngërthyer në etapat karakteristike të çdo procesi mësimor, pavarësisht nëse mbështetet apo jo nga teknologjia. Kompetencat e renditura në këto fusha shtjellojnë në detaje mënyrën se si të përdoren në mënyrë efektive dhe novatore teknologjitë digjitale gjatë planifikimit (Fusha 2), implementimit (Fusha 3) dhe vlerësimit (Fusha 4) të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Fusha 5 njeh potencialin e teknologjive digjitale për strategjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies të përqendruara te nxënësi. Kjo fushë është ndërsektoriale me Fushat 2, 3 dhe 4, në kuptimin që përmban një grup parimesh udhëzuese që janë të rëndësishme dhe komplementare për kompetencat e përcaktuara në këto fusha.

Për shembull, një edukator i zoti në Fushën 2 do të përzgjedhë, krijojë dhe përshtatë resurse digjitale që u përgjigjen objektivave mësimore dhe nivelit ekzistues të kompetencës të grupit të nxënësve. Në mënyrë ideale, ai/ajo do të zgjedhë dhe/ose kombinojë aktivitete mësimore që u ndihmojnë nxënësve të arrijnë me efektivitet një objektivi të caktuar mësimor. Ndërsa një edukator i zoti në Fushën 5 do të përzgjedhë, krijojë dhe përshtatë resurse digjitale për të fuqizuar nxënësit. Në këtë drejtim, ai/ajo do të sigurojë që resurset të jenë të qasshme për të gjithë nxënësit; do të parashohë rrugë të ndryshme, të personalizuar të mësimnxënies; dhe do të hartojë resurse që nxisin përfshirjen dhe angazhimin aktiv të të gjithë nxënësve. Është e qartë se një edukator kompetent nga aspekti digjital duhet të marrë parasysh të dy grupet e objektivave, pra të adresojë objektivin konkret mësimor (Fusha 2) dhe të fuqizojë nxënësit (Fusha 5). Nëse i pari lidhet posaçërisht me procesin e përzgjedhjes ose krijimit, i dyti është i aplikueshëm në mënyrë të përgjithshme në të gjitha kompetencat e Fushave 2-4.

Kjo bërthamë pedagogjike e kornizës plotësohet nga Fushat 1 dhe 6. Fusha 1 është e orientuar drejt mjedisit profesional më të gjerë, duke përfshirë përdorimin e teknologjive digjitale nga edukatorët në ndërveprimet profesionale me kolegët, nxënësit, prindërit dhe palët e tjera të interesuara, si dhe në zhvillimin e tyre profesional individual dhe për të mirën kolektive të organizatës. Fusha 6 detajon kompetencat pedagogjike specifike të nevojshme për të lehtësuar zhvillimin e kompetencës digjitale të nxënësve.

Të dyja fushat njohin faktin se kompetenca digjitale e edukatorëve shkon përtej përdorimit konkret të teknologjive digjitale brenda proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Edukatorët kompetentë nga aspekti digjital duhet të marrin parasysh edhe mjedisin e përgjithshëm në të cilin zhvillohen proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Prandaj, pjesë e kompetencës digjitale të edukatorëve është të mundësojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën dhe punën në epokën digjitale. Gjithashtu, pjesë e kësaj kompetence është edhe shfrytëzimi i përfitimeve që ofrojnë teknologjitë digjitale për përmirësimin e praktikave pedagogjike dhe strategjive organizative.



A photograph of two children, a girl and a boy, smiling and working together on a project. They are sitting at a table, and their hands are visible as they work on a piece of paper. The image is overlaid with a teal diamond-shaped graphic. The text "Korniza DigCompEdu e shpjeguar" is written in white on the right side of the image.

Korniza DigCompEdu e shpjeguar




FIGURA 4: SINTEZA E KORNIZËS DIGCOMPEDU

01 Angazhimi profesional

Kompetenca digjitale e edukatorëve shprehet përmes aftësisë së tyre për të përdorur teknologjitë digjitale jo vetëm për të përmirësuar mësimdhënien, por edhe për ndërveprimet profesionale me kolegë, nxënës, prindër dhe palë të tjera të interesuara; për zhvillimin e tyre profesional individual; si dhe për të mirën kolektive dhe për nxitjen e novacionit të vazhdueshëm në organizatë dhe në profesionin e mësimdhënies. Ky është fokusi i Fushës 1.

Angazhimi profesional



Komunikimi organizativ

Të përdoren teknologji digjitale për të përmirësuar komunikimin organizativ me nxënësit, prindërit dhe palët e treta. Të kontribuohet në zhvillimin dhe përmirësimin e strategjive të komunikimit organizativ në mënyrë bashkëpunuese.



Bashkëpunimi profesional

Të përdoren teknologji digjitale për t'u angazhuar në bashkëpunim me mësimdhënës të tjerë, për të ndarë dhe shkëmbyer njohuri e përvoja, si dhe për të sjellë novacion në praktikat pedagogjike në mënyrë bashkëpunuese.



Praktika reflektuese

Të reflektohet në nivel individual dhe kolektiv, të vlerësohet në mënyrë kritike dhe të zhvillohet në mënyrë aktive praktika digjitale pedagogjike individuale dhe e komunitetit arsimor.



Zhvillimi i vazhdueshëm profesional (ZHPV/CPD) digjital

Të përdoren burime dhe resurse digjitale për zhvillim të vazhdueshëm

TABELA 1: FUSHA 1 - ANGZHIMI PROFESIONAL

02 Resurset digjitale

Mësimdhënësit sot përballen me një bollëk të resurseve digjitale (arsimore) që mund t'i përdorin për mësimdhënie. Një nga kompetencat kryesore që çdo mësimdhënësi duhet të zhvillojë është aftësia për t'i dalë mbanë kësaj larmie, për të identifikuar në mënyrë efektive resurset që përshtaten më së miri me objektivat mësimore, grupin e nxënësve dhe stilin e mësimdhënies, për të strukturuar këtë pasuri materiale, për të vendosur ndërlidhje dhe për t'i modifikuar, plotësuar apo zhvilluar vetë resurset digjitale që mbështesin mësimdhënien e tyre.

Në të njëjtën kohë, ata duhet të jenë të vetëdijshëm për përdorimin dhe menaxhimin me përgjegjësi të përmbajtjeve digjitale. Duhet të respektojnë rregullat e të drejtës së autorit gjatë përdorimit, modifikimit dhe ndarjes së resurseve, si dhe të mbrojnë përmbajtje dhe të dhëna të ndjeshme, si p.sh., provimet ose notat e nxënësve në formë digjitale.

Resurset digjitale



Përzgjedhja e resurseve digjitale

Të identifikohen, vlerësohen dhe përzgjidhen resurset digjitale për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Të merren parasysh objektivi i veçantë mësimor, konteksti, qasja pedagogjike dhe grupi i nxënësve gjatë përzgjedhjes së resurseve digjitale dhe planifikimit të përdorimit të tyre.



Krijimi dhe modifikimi i resurseve digjitale

Të modifikohen dhe zhvillohen më tej resurset ekzistuese me licencë të hapur dhe resurse të tjera kur kjo lejohet. Të krijohen ose bashkë-krijohen resurse të reja arsimore digjitale. Të merren parasysh objektivi i veçantë mësimor, konteksti, qasja pedagogjike dhe grupi i nxënësve gjatë hartimit të resurseve digjitale dhe planifikimit të përdorimit të tyre.



Menaxhimi, mbrojtja dhe ndarja e resurseve digjitale

Të organizohet përmbajtja digjitale dhe të bëhet e qasshme për nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit e tjerë. Të mbrohet në mënyrë efektive përmbajtja digjitale e ndjeshme. Të respektohen dhe të aplikohen saktë rregullat për privatësinë dhe të drejtën e autorit. Të kuptohet përdorimi dhe krijimi i licencave të hapura dhe i resurseve arsimore të hapura, përfshirë atributimin e tyre sipas rregullave.

TABELA 2: FUSHA 2 - RESURSET DIGJITALE

03 Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Teknologjitë digjitale mund të forcojnë dhe përmirësojnë strategjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në mënyra të ndryshme. Megjithatë, pavarësisht nga strategjia ose qasja pedagogjike e zgjedhur, kompetenca e veçantë digjitale e edukatorit qëndron në orkestrimin efektiv të përdorimit të teknologjive digjitale në fazat dhe mjediset e ndryshme të procesit mësimor. Kompetenca themelore në këtë fushë – dhe mbase e të gjithë kornizës – është 3.1: Mësimdhënia. Kjo kompetencë i referohet hartimit, planifikimit dhe implementimit të përdorimit të teknologjive digjitale në etapat e ndryshme të procesit të mësimnxënies.

Kompetencat 3.2 deri 3.4 e plotësojnë këtë kompetencë duke theksuar se potenciali i vërtetë i teknologjive digjitale qëndron në zhvendosjen e fokusit të procesit mësimor nga ai i udhëhequr nga mësimdhënësi drejt proceseve të përqendruara te nxënësi. Rrjedhimisht, roli i një edukatori kompetent nga aspekti digjital është të jetë mentor dhe udhërrëfyes për nxënësit në përpjekjet e tyre gjithnjë e më autonome për mësimnxënie. Në këtë kuptim, edukatorët kompetentë nga aspekti digjital duhet të jenë në gjendje të hartojnë mënyra të reja, të mbështetura nga teknologjitë digjitale, për të ofruar udhëzim dhe mbështetje për nxënësit, individualisht dhe në grup (3.2), si dhe për të iniciuar, mbështetur dhe monitoruar aktivitetet e mësimnxënies së vetë-rregulluar (3.4) dhe bashkëpunuese (3.3).

Mësimdhënia dhe mësimnxënia



Mësimdhënia

Të planifikohen dhe implementohen pajisje dhe resurse digjitale në procesin e mësimdhënies, me qëllim të rritjes së efektivitetit të ndërhyrjeve të mësimdhënies. Të menaxhohen dhe orkestrohen në mënyrë të përshtatshme strategjitë digjitale të mësimdhënies. Të eksperimentohet me, por edhe të zhvillohen, formate dhe metoda të reja pedagogjike për mësimdhënie.



Udhëzimi

Të përdoren teknologji dhe shërbime digjitale për të forcuar ndërveprimin me nxënësit, individualisht dhe në grup, brenda dhe jashtë sesioneve apo orëve mësimore. Të përdoren teknologji digjitale për të ofruar udhëzim dhe asistencë me kohë dhe të përshtatur për nevojat e nxënësve. Të eksperimentohet me, por edhe të zhvillohen, forma dhe formate të reja për ofrimin e udhëzimit dhe mbështetjes.



Mësimnxënia bashkëpunuese

Të përdoren teknologji digjitale për të nxitur dhe përforcuar bashkëpunimin ndërmjet nxënësve. T'u mundësohet nxënësve të përdorin teknologjitë digjitale si pjesë e detyrave bashkëpunuese, duke i përdorur ato si mjet për të forcuar komunikimin, bashkëpunimin dhe krijimin e njohurive në mënyrë kolektive.



Mësimnxënia e vetë-rregulluar

Të përdoren teknologji digjitale për të mbështetur mësimnxënien e vetë-rregulluar të nxënësve, pra për t'u mundësuar atyre të planifikojnë, monitorojnë dhe reflektojnë mbi procesin e tyre të mësimnxënies, të ofrojnë dëshmi mbi progresin, të ndajnë përvoja dhe të ofrojnë zgjidhje kreative.

04 Vlerësimi

Vlerësimi mund të shërbejë si lehtësues por edhe si pengesë për novacionin në arsim. Gjatë integritit të teknologjive digjitale në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duhet të merret parasysh se si këto teknologji digjitale mund të përmirësojnë strategjitë ekzistuese të vlerësimit. Në të njëjtën kohë, duhet të merret parasysh edhe se si këto teknologji mund të përdoren për të krijuar ose lehtësuar qasje novatore ndaj vlerësimit. Edukatorët kompetentë nga aspekti digjital duhet të jenë në gjendje të përdorin teknologjitë digjitale në vlerësim me këto dy qëllime në mendje.

Për më tepër, përdorimi i teknologjive digjitale në arsim, qoftë për vlerësim, mësimnxënie, administrim apo qëllime të tjera, gjeneron një gamë të gjerë të dhënash mbi sjelljen mësimore të çdo nxënësi individual. Analizimi dhe interpretimi i këtyre të dhënave dhe përdorimi i tyre për të ndihmuar në marrjen e vendimeve po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm – i plotësuar nga analiza e të dhënave konvencionale mbi sjelljen e nxënësve.

Në të njëjtën kohë, teknologjitë digjitale mund të kontribuojnë në monitorimin e drejtpërdrejtë të përparimit të nxënësve, lehtësimin e dhënies së informacioneve kthyes (feedback) dhe mundësimin që edukatorët të vlerësojnë dhe përshtatin strategjitë e tyre të mësimdhënies.

Vlerësimi



Strategjitë e vlerësimit

Të përdoren teknologji digjitale për vlerësimin formativ dhe sumativ. Të përmirësohet diversiteti dhe përshtatshmëria e formateve dhe qasjeve ndaj vlerësimit.



Analizimi i dëshmimeve

Të gjenerohen, përzgjidhen, analizohen dhe interpretohen në mënyrë kritike dëshmitë digjitale mbi aktivitetin, performancën dhe progresin e nxënësve, me qëllim informimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.



Informacioni kthyes (feedback) dhe planifikimi

Të përdoren teknologji digjitale për t'u ofruar nxënësve informacion kthyes (feedback) në mënyrë të synuar dhe me kohë. Të përshtaten strategjitë e mësimdhënies dhe të ofrohet mbështetje në mënyrë të synuar, bazuar në dëshmitë e gjeneruara nga teknologjitë digjitale që përdoren. T'u mundësohet nxënësve dhe prindërve të kuptojnë dëshmitë e ofruara nga teknologjitë digjitale dhe t'i përdorin ato për marrjen e vendimeve.

TABELA 4: FUSHA 4 - VLERËSIMI DIGJITAL

05 Fuqizimi i nxënësve

Një nga përparësitë kryesore të teknologjive digjitale në arsim është potenciali i tyre për të mbështetur strategjitë pedagogjike të përqendruara te nxënësi, për të rritur përfshirjen aktive të nxënësve në procesin e mësimnxënies dhe për të rritur te nxënësit ndjenjën e përgjegjësisë për këtë proces. Prandaj, teknologjitë digjitale mund të përdoren për të lehtësuar angazhimin aktiv të nxënësve, p.sh. gjatë eksplorimit të një teme, eksperimentimit me opsione ose zgjidhje të ndryshme, kuptimit të ndërlidhjeve, gjetjes së zgjidhjeve kreative ose krijimit të një artefakti dhe reflektimit mbi të.

Për më tepër, teknologjitë digjitale mund të kontribuojnë në mbështetjen e diferencimit në klasë dhe të edukimit të personalizuar, duke ofruar aktivitete mësimore të përshtatura për nivelin e kompetencës, interesat dhe nevojat mësimore të secilit nxënësi. Në të njëjtën kohë, duhet pasur kujdes që të mos përqendrohen pabarazitë ekzistuese (p.sh. në qasjen ndaj teknologjive digjitale ose aftësive digjitale) dhe të sigurohet qasje e barabartë për të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevojat e veçanta arsimore.

Fuqizimi i nxënësve



Qasje dhe përfshirja

Të sigurohet qasja në resurse dhe aktivitete mësimore për të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevojat e veçanta. Të merren parasysh dhe t'u delet ndesh pritshmërive, aftësive, përdorimeve dhe keqkuptimeve (digjitale) të nxënësve, si dhe kufizimeve kontekstuale, fizike ose njohëse në përdorimin e teknologjive digjitale.



Diferencimi dhe personalizimi

Të përdoren teknologji digjitale për të adresuar nevojat e ndryshme mësimore të nxënësve, duke mundësuar që ata të avancojnë në nivele dhe shpejtësi të ndryshme, dhe të ndjekin rrugë dhe objektiva mësimore individuale.



Angazhimi aktiv i nxënësve

Të përdoren teknologji digjitale për të nxitur angazhimin aktiv dhe kreativ të nxënësve me lëndën përkatëse. Të përdoren teknologji digjitale brenda strategjive pedagogjike që zhvillojnë aftësitë transversale të nxënësve, mendimin e thellë dhe shprehjen kreative. Të hapet procesi i mësimnxënies ndaj konteksteve të reja nga bota reale, duke përfshirë nxënësit në aktivitete praktike, hulumtime shkencore ose zgjidhje problemesh komplekse, apo në mënyra të tjera që rrisin përfshirjen aktive të nxënësve në lëndë komplekse.

TABELA 5: FUSHA 5 – FUQIZIMI I NXËNËSVE



06 Lehtësimi i zhvillimit të kompetencës digjitale të nxënësve

Kompetenca digjitale është një nga kompetencat transversale që edukatorët duhet të kultivojnë te nxënësit. Ndërsa promovimi i kompetencave të tjera transversale është vetëm një pjesë e kompetencës digjitale të edukatorëve në masën që teknologjitë digjitale përdoren për këtë qëllim, aftësia për të lehtësuar zhvillimin e kompetencës digjitale të nxënësve është pjesë integrale e kompetencës digjitale të edukatorëve. Për këtë arsye, kjo aftësi meriton një fushë të veçantë brenda kornizës DigCompEdu.

Kompetenca digjitale e nxënësve kapet nga Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale të Qytetarëve (DigComp). Prandaj, fusha përkatëse e DigCompEdu ndjek të njëjtën logjikë dhe përshkruan pesë kompetenca të harmonizuara në përmbajtje dhe përshkrim me DigComp. Mirëpo, titujt janë përshtatur për të theksuar dimensionin pedagogjik dhe fokusin brenda kësaj kornize.

Lehtësimi i zhvillimit të kompetencës digjitale të nxënësve



Kultura e informacionit dhe mediave

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të artikulojnë nevojat për informacion; të gjejnë informacion dhe resurse në mjedise digjitale; të organizojnë, përpunojnë, analizojnë dhe interpretojnë informacionin; dhe të krahasojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike besueshmërinë dhe kredibilitetin e informacionit dhe burimeve të tij.



Komunikimi dhe bashkëpunimi digjital

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të përdorin teknologjitë digjitale në mënyrë efektive dhe me përgjegjësi për komunikim, bashkëpunim dhe pjesëmarrje qytetare.



Krijimi i përmbajtjes digjitale

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të shprehin përmes mjeteve digjitale dhe të modifikojnë dhe krijojnë përmbajtje digjitale në formate të ndryshme. Të mësohen nxënësit se si aplikohen të drejtat e autorit dhe licencat për përmbajtjen digjitale, si të referojnë burimet dhe si të atribuojnë licencat.



Përdorimi me përgjegjësi

Të merren masa për të siguruar mirëqenien fizike, psikologjike dhe sociale të nxënësve gjatë përdorimit të teknologjive digjitale. Të fuqizohen nxënësit për të menaxhuar risqet dhe për të përdorur teknologjitë digjitale në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi.



Zgjidhja digjitale e problemeve

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të identifikojnë dhe zgjidhin probleme teknike, ose të transferojnë në mënyrë kreative njohuritë teknologjike në situata të reja.

TABELA 6: FUSHA 6 - LEHTËSIMI I ZHVILLIMIT TË KOMPETENCËS DIGJITALE TË NXËNËSVE



1. Angazhimi profesional

1.1 Komunikimi organizativ

Të përdoren teknologji digjitale për të përmirësuar komunikimin organizativ me nxënësit, prindërit dhe palët e treta. Të kontribuohet në zhvillimin dhe përmirësimin e strategjive të komunikimit organizativ në mënyrë bashkëpunuese.

1.2 Bashkëpunimi profesional Të përdoren teknologji digjitale për t'u angazhuar në bashkëpunim me mësimdhënës të tjerë, për të ndarë dhe shkëmbyer njohuri e përvoja, si dhe për të sjellë novacion në praktikat pedagogjike në mënyrë bashkëpunuese.

1.3 Praktika reflektuese Të reflektohet në nivel individual dhe kolektiv, të vlerësohet në mënyrë kritike dhe të zhvillohet në mënyrë aktive praktika digjitale pedagogjike individuale dhe e komunitetit arsimor.

1.4 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional (ZHVP/CPD) digjital Të përdoren burime dhe resurse digjitale për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

2. Resurset digjitale

2.1 Përzgjedhja e resurseve digjitale Të identifikohen, vlerësohen dhe përzgjidhen resurset digjitale për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Të merren parasysh objektivi i veçantë mësimor, konteksti, qasja pedagogjike dhe grupi i nxënësve gjatë hartimit të resurseve digjitale dhe planifikimit të përdorimit të tyre.

2.2 Krijimi dhe modifikimi i resurseve digjitale Të modifikohen dhe zhvillohen më tej resurset ekzistuese me licencë të hapur dhe resurse të tjera kur kjo lejohet. Të krijohen ose bashkë-krijohen resurse të reja arsimore digjitale. Të merren parasysh objektivi i veçantë mësimor, konteksti, qasja pedagogjike dhe grupi i nxënësve gjatë hartimit të resurseve digjitale dhe planifikimit të përdorimit të tyre.

2.3 Menaxhimi, mbrojtja dhe ndarja e resurseve digjitale Të organizohet përmbajtja digjitale dhe të bëhet e qasshme për nxënësit, prindërit dhe mësimdhënës të tjerë. Të mbrohet në mënyrë efektive përmbajtja digjitale e ndjeshme. Të respektohen dhe të aplikohen saktë rregullat për privatësinë dhe të drejtën e autorit. Të kuptohet përdorimi dhe krijimi i licencave të hapura dhe i resurseve arsimore të hapura, përfshirë atribuimin e tyre sipas rregullave.

3. Mësimdhënia dhe mësimnxënia

3.1 Mësimdhënia

Të planifikohen dhe implementohen pajisje dhe resurse digjitale në procesin e mësimdhënies, me qëllim të rritjes së efektivitetit të ndërhyrjeve të mësimdhënies. Të menaxhohen dhe orkestrohen në mënyrë të përshtatshme ndërhyrjet digjitale të mësimdhënies. Të eksperimentohet me, por edhe të zhvillohen, formate dhe metoda të reja pedagogjike për mësimdhënie.

3.2 Udhëzime

Të përdoren teknologji dhe shërbime digjitale për të forcuar ndërveprimin me nxënësit, individualisht dhe në grup, brenda dhe jashtë sesioneve apo orëve mësimore. Të përdoren teknologjitë digjitale për të ofruar udhëzim dhe asistencë me kohë dhe të përshtatur për nevojat e nxënësve. Të eksperimentohet me, por edhe të zhvillohen, forma dhe formate të reja për ofrimin e udhëzimit dhe mbështetjes.

3.3 Mësimnxënia bashkëpunuese

Të përdoren teknologji digjitale për të nxitur dhe përforcuar bashkëpunimin ndërmjet nxënësve. T'u mundësohet nxënësve të përdorin teknologjitë digjitale si pjesë e detyrave bashkëpunuese, duke i përdorur ato si mjet për të forcuar komunikimin, bashkëpunimin dhe krijimin e njohurive në mënyrë kolektive.

3.4 Mësimnxënia e vetë-rregulluar

Të përdoren teknologji digjitale për të mbështetur proceset e vetë-rregulluara të mësimnxënies, pra për t'u mundësuar nxënësve të planifikojnë, monitorojnë dhe reflektojnë mbi procesin e tyre të mësimnxënies, të ofrojnë dëshmi mbi progresin, të ndajnë përvoja dhe të ofrojnë zgjidhje kreative.

4. Vlerësimi

4.1 Strategjitë e vlerësimit Të përdoren teknologji digjitale për vlerësimin formativ dhe sumativ. Të përmirësohet diversiteti dhe përshtatshmëria e formateve dhe qasjeve ndaj vlerësimit.

4.2 Analizimi i dëshmive Të gjenerohen, përzgjidhen, analizohen dhe interpretohen në mënyrë kritike dëshmitë digjitale mbi aktivitetin, performancën dhe progresin e nxënësve, me qëllim informimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

4.3 Informacioni kthyes (feedback) dhe planifikimi Të përdoren teknologji digjitale për t'u ofruar nxënësve informacion kthyes (feedback) në mënyrë të synuar dhe me kohë. Të përshtaten strategjitë e mësimdhënies dhe të ofrohet mbështetje në mënyrë të synuar, bazuar në dëshmitë e gjeneruara nga teknologjitë digjitale që përdoren. T'u mundësohet nxënësve dhe prindërve të kuptojnë dëshmitë e ofruara nga teknologjitë digjitale dhe t'i përdorin ato për marrjen e vendimeve.

5. Fuqizimi i nxënësve

5.1 Qasja dhe përfshirja Të sigurohet qasja në resurse dhe aktivitete mësimore për të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevojë të veçanta. Të merren parasysh dhe të adresohen

pritshtëritë, aftësitë, përdorimet dhe keqkuptimet (digjitale) të nxënësve, si dhe kufizimet kontekstuale, fizike ose njohëse në përdorimin e teknologjive digjitale.

5.2 Diferencimi dhe personalizimi

Të përdoren teknologji digjitale për të adresuar nevojat e ndryshme mësimore të nxënësve, duke mundësuar që ata të avancojnë në nivele dhe shpejtësi të ndryshme, dhe të ndjekin rrugë dhe objektiva mësimore individuale.

5.3 Angazhimi aktiv i nxënësve

Të përdoren teknologji digjitale për të nxitur angazhimin aktiv dhe kreativ të nxënësve me lëndën përkatëse. Të përdoren teknologjitë digjitale brenda strategjive pedagogjike që zhvillojnë aftësitë transversale të nxënësve, mendimin e thellë dhe shprehjen kreative. Të hapet procesi i mësimnxënies ndaj konteksteve të reja nga bota reale, duke përfshirë nxënësit në aktivitete praktike, hulumtime shkencore ose zgjidhje problemesh komplekse, apo në mënyra të tjera që rrisin përfshirjen aktive të nxënësve në lëndë komplekse.

6. Lehtësimi i zhvillimit të kompetencës digjitale të nxënësve

6.1 Kultura e informacionit dhe mediave

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të artikulojnë nevojat për informacion; të gjejnë informacion dhe resurse në mjedise digjitale; të organizojnë, përpunojnë, analizojnë dhe interpretojnë informacionin; dhe të krahasojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike besueshmërinë dhe kredibilitetin e informacionit dhe burimeve të tij.

6.2 Komunikimi dhe bashkëpunimi digjital

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të përdorin teknologjitë digjitale në mënyrë efektive dhe me përgjegjësi për komunikim, bashkëpunim dhe pjesëmarrje qytetare.

6.3 Krijimi i përmbajtjes digjitale

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të shprehin përmes mjeteve digjitale dhe të modifikojnë dhe krijojnë përmbajtje digjitale në formate të ndryshme. Të mësohen nxënësit se si aplikohen të drejtat e autorit dhe licencat për përmbajtjen digjitale, si të referojnë burimet dhe si të atribuojnë licencat.

6.4. Përdorimi me përgjegjësi

Të merren masa për të siguruar mirëqenien fizike, psikologjike dhe sociale të nxënësve gjatë përdorimit të teknologjive digjitale. Të fuqizohen nxënësit për të menaxhuar risqet dhe për të përdorur teknologjitë digjitale në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi.

6.5 Zgjidhja digjitale e problemeve

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të identifikojnë dhe zgjidhin probleme teknike, ose të transferojnë në mënyrë kreative njohuritë teknologjike në situata të reja.



Korniza DigCompEdu
në hollësi

Si mund të zhvillojnë edukatorët kompetencën e tyre digjitale?

Ky kapitull përshkruan më në thellësi se çfarë do të thotë të jesh edukator kompetent nga aspekti digjital. Për secilën nga 22 kompetencat elementare, përshkruesi i kompetencës shoqërohet me një listë aktiviteteve tipike. Propozohet një model progresioni në gjashtë nivele, për të cilat ofrohet një rubrikë me deklarata zotësie për vetë-vlerësim.

Terminologjia

Përshkrues i kompetencës

Titulli dhe një përshkrim i shkurtër. Përshkrimi i shkurtër mund të përbëhet nga një ose disa fjali. Qëllimi i tij është të përshkruajë në mënyrë të përmblodhur dhe gjithëpërfshirëse kompetencën në fjalë. Ky përshkrim paraqet pikë-referimin kryesor. Çdo aktivitet që përfshihet brenda këtij përshkrimi duhet të konsiderohet si shprehje e kësaj kompetence. Çdo aktivitet që bie jashtë fushës së këtij përshkrimi nuk konsiderohet pjesë e kësaj kompetence.

Aktivitete

Një listë e aktiviteteve që përfaqësojnë shembuj të kësaj kompetence. Kjo listë ka për qëllim t'u tregojë përdoruesve të kornizës se çfarë lloj aktiviteteve mbulon kompetenca në fjalë. Megjithatë, kjo listë nuk është shteruese: ajo vetëm ilustron fokusin dhe fushëveprimin e kompetencës, pa e kufizuar atë. Për më tepër, me zhvillimin e teknologjive digjitale dhe ndryshimin e mënyrave të përdorimit, disa nga aktivitetet e renditura mund të mos jenë më të aplikueshme, ndërsa të tjera mund të jetë e nevojshme të shtohen.

Progresion

Një përshkrim i përgjithshëm se si kjo kompetencë shfaqet në nivele të ndryshme zotësie. Progresioni është kumulativ, në kuptimin që çdo përshkrues në nivel më të lartë përfshin të gjithë përshkruesit e niveleve më të ulëta. Progresioni ndjek logjikën që është e qenësishme për kompetencën në fjalë, e cila mund të jetë e ndryshme nga ajo e kompetencave të tjera.

Deklarata zotësie

Një varg deklaratash të zotësisë që ilustronë aktivitete tipike në secilin nivel zotësie. Kjo listë deklaratash i nënshtrohet rishikimit të vazhdueshëm dhe duhet të konsiderohet vetëm si një mjet për të ilustruar progresionin e zotësisë. Meqenëse progresioni i niveleve të zotësisë është kumulativ, një person kompetent në një nivel të avancuar duhet të jetë në gjendje të kryejë aktivitetet në atë nivel dhe në të gjitha nivelet më të ulëta, me përjashtim të nivelit më të ulët (A1).

Teknologji digjitale

Në të gjithë tabelat, koncepti i “teknologjive digjitale” përdoret si term ombrellë për resurset dhe pajisjet digjitale, duke përfshirë kështu çdo lloj hyrjeje digjitale: softuerin (përfshirë aplikacionet dhe lojërat), harduerin (p.sh. teknologjitë e klasës ose pajisjet mobile), ose përmbajtjen/të dhënat digjitale (pra, çdo lloj skedari, duke përfshirë imazhe, audio dhe video). Për më shumë informacion të detajuar mbi terminologjinë e përdorur në këtë raport, ju lutemi t'i referoheni fjalorthit shpjegues.



Modeli i progresionit

Modeli i propozuar i progresionit synon të ndihmojë edukatorët të kuptojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta, duke përshkruar etapat ose nivelet e ndryshme të zhvillimit të kompetencës digjitale. Për lehtësi reference, këto etapa të kompetencës lidhen me gjashtë nivelet e zotësisë të përdorura nga Korniza e Përbashkët Evropiane e Referencës për Gjuhët (CEFR), që variojnë nga A1 deri në C2.

Ekzistojnë disa përparësi të përdorimit të taksonomisë sipas CEFR: Meqenëse nivelet e CEFR njihen dhe përdoren gjerësisht, edukatorët e kanë më të lehtë të kuptojnë dhe të vlerësojnë nivelin e tyre personal të kompetencës digjitale. Përdorimi i këtyre niveleve të konsoliduara gjithashtu i jep koherencë kornizave evropiane. Nga pikëpamja praktike, kjo nënkupton se, kur deklarojnë nivelin e kompetencës digjitale të lidhur me rolin e edukatorit në biografinë e tyre (CV), mësimdhënësit mund t'u referohen të njëjtave nivele sikurse për kompetencën gjuhësore. Më e rëndësishmja, duke qenë se edukatorët e dinë që nivelet e kompetencës së tyre gjuhësore mund të dallojnë kur krahasojnë, p.sh., aftësitë e dëgjimit, të folurit dhe të shkrimit, për ta do të jetë e natyrshme të pranojnë që kompetenca e tyre digjitale duhet të vlerësohet sipas fushave dhe mund të ndryshojë dukshëm nga një fushë në tjetrën. Kjo do t'u ndihmojë atyre të përqendrohen më lehtë në nevojat e tyre specifike për zhvillim. Në fund, nga këndvështrimi konceptual, CEFR i organizon gjashtë nivelet në tre blloqe, gjë që pasqyron faktin se, ndërkohë që nivelet A1 dhe A2, B1 dhe B2, si dhe C1 dhe C2 janë ngushtë të ndërlidhura, ekziston një kërcim i dukshëm njohës midis A2 dhe B1, dhe midis B2 dhe C1. E njëjta gjë vlen edhe për progresionin e kompetencës sipas Kornizës DigCompEdu.

Megjithatë, disavantazhi kryesor i këtyre niveleve është se ato mund të perceptohen si kërcënuese. Qëllimi kryesor i modelit të propozuar të progresionit DigCompEdu është mbështetja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Ai nuk është menduar të shërbejë si kornizë normative apo si mjet për vlerësimin e performancës. Përkundrazi, 22 kompetencat shpjegohen në gjashtë etapa, për të informuar edukatorët se ku ndodhen, çfarë kanë arritur deri më tani dhe cilët do të ishin hapat e ardhshëm nëse duan të zhvillojnë më tej kompetencën specifike. Deklaratat e zotësisë janë formuluar për të vlerësuar arritjet dhe për të inkurajuar edukatorët të zhvillojnë kompetencat e tyre, duke dhënë hapa të vegjël, të cilët me kalimin e kohës, gradualisht, rrisin vetëbesimin dhe kompetencën e tyre. Ideja kryesore e progresionit të zotësisë është të bëjë të qarta etapat e ndryshme nëpërmjet të cilave zakonisht zhvillohet secila kompetencë elementare, në mënyrë që t'u ndihmojë edukatorëve të identifikojnë dhe të vendosin për masat konkrete që duhet të ndërmarrin për të forcuar kompetencën e tyre në etapën ku ndodhen aktualisht.

Së këndejmi, për të inkurajuar edukatorët që ta përdorin Kornizën DigCompEdu si një mjet për zhvillimin e tyre profesional, është vendosur që nivelet e CEFR të shoqërohen me përshkrues motivues të roleve, duke filluar nga Fillestar/Newcomer (A1) deri te Pionier/Pioneer (C2). Këta përshkrues kanë për qëllim t'i motivojnë edukatorët në të gjitha nivelet që të vlerësojnë pozitivisht arritjet e tyre dhe të presin me padurim zgjerimin e mëtejshëm të tyre.






FIGURA 5: KORNIZA DIGCOMPEDU: MODELI I PROGRESIONIT

Këto etapa dhe logjika e progresionit të tyre janë frymëzuar nga taksonomia sipas Bloom, e rishikuar. Njihet gjerësisht se kjo taksonomi shpjegon në mënyrë të qartë etapat e njëpasnjëshme njohëse të çdo progresi në mësimnxënien, duke filluar nga “Kujtimi” dhe “Kuptimi”, të “Aplikimi” dhe “Analizimi”, dhe në fund të “Vlerësimi” dhe “Krijimi”. Në mënyrë të ngjashme, në dy etapat e para të DigCompEdu, Fillestar/Newcomer (A1) dhe Eksplorues/Explorer (A2), edukatorët përvetësojnë informacione të reja dhe zhvillojnë praktika digjitale themelore; në dy etapat pasuese, Integrues/Integrator (B1) dhe Ekspert/Expert (B2), edukatorët aplikojnë, zgjerojnë më tej dhe reflektojnë mbi praktikatat e tyre digjitale; ndërsa në etapat më të larta, Udhëheqës/Leader (C1) dhe Pionier/Pioneer (C2), edukatorët përcjellin njohuritë e tyre, japin kritika konstruktive të praktikave ekzistuese dhe zhvillojnë praktika të reja.

Emërtimet për secilin nivel kompetence janë përzgjedhur për të pasqyruar theksin e veçantë në përdorimin e teknologjisë digjitale, që është tipik për atë etapë kompetence. Për shembull, të jesh në nivelin Integrues/Integrator (B1) sa i përket praktikave të mësimdhënies (Fusha 3), nënkupton që fokusi aktual i zhvillimit të kompetencës së edukatorit është në integrimin e një game

teknologjish digjitale në mësimdhënie dhe mësimnxënien. Kjo nënkupton se hapi i radhës për zhvillimin e kompetencës digjitale të këtij edukatori do të ishte kalimi në fazën e Ekspertit/Expert (B2), pra fitimi i më shumë vetëbesimi, kuptimi më i mirë i asaj se çfarë funksionon, kur dhe pse, si dhe aftësia për të gjetur zgjidhje të përshtatshme dhe novatore, përfshirë edhe ato për situata më komplekse.

Në këtë kuptim, përshkruesit lidhen gjithashtu me pikat e forta relative dhe rolet e edukatorit brenda një komuniteti profesional. Për shembull, brenda një ekipi edukatorësh që bashkëpunojnë në një projekt: një Integrues/Integrator (B1) është më i përshtatshëm për të kërkuar ide dhe mjete të reja; një koleg në nivelin Ekspert/Expert (B2) mund të jetë më i aftë për të vendosur se si të implementohen këto; një koleg në nivelin Eksplorues/Explorer (A2) mund të identifikojë më së miri problemet e mundshme me të cilat mund të hasin nxënësit në përdorimin e teknologjive digjitale; ndërsa roli i Udhëheqës/Leader (C1) ose Pionierit/Pioneer (C2) të ekipit do të ishte të formësojë projektin në mënyrë që të shfrytëzohet potenciali novator i teknologjive digjitale për të përmirësuar mësimnxënien dhe për të fuqizuar nxënësit.

1. Anderson, L.W., and D. Krathwohl (Eds.) (2001). A Taxonomy for Learning, Teaching and Assessing: a Revision of Bloom's Taxonomy of Educational Objectives. Longman, New York.

Nivelet e zotësisë

Në përgjithësi, përshkrimet e mëposhtme aplikohen për etapat e ndryshme të kompetencës:

Fillestar/Newcomer (A1)

Fillestarët janë të vetëdijshëm për potencialin e teknologjive digjitale për të përmirësuar praktikën pedagogjike dhe profesionale. Megjithatë, ata kanë pasur shumë pak kontakt me teknologjitë digjitale dhe i përdorin ato kryesisht për përgatitjen e mësimeve, për administrim ose për komunikim organizativ. Fillestarëve u nevojitet udhëzim dhe inkurajim për të zgjeruar repertorin e tyre dhe për ta aplikuar kompetencën ekzistuese digjitale në fushën pedagogjike.

Eksplorues/Explorer (A2)

Eksploruesit janë të vetëdijshëm për potencialin e teknologjive digjitale dhe janë të interesuar t'i eksplorojnë ato për të përmirësuar praktikën pedagogjike dhe profesionale. Ata kanë filluar të përdorin teknologjitë digjitale në disa fusha të kompetencës digjitale, por pa ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse apo të qëndrueshme. Eksploruesve u nevojitet inkurajim, qartësi dhe frymëzim, p.sh. përmes shembujve dhe udhëzimeve nga kolegët, të integruara në një shkëmbim bashkëpunues të praktikave.

Integrues/Integrator (B1):

Integruesit eksperimentojnë me teknologjitë digjitale në një sërë kontekstesh dhe për një gamë qëllimesh, duke i integruar ato në shumë prej praktikave të tyre. Ata i përdorin teknologjitë digjitale në mënyrë krijuese për të përmirësuar aspekte të ndryshme të angazhimit profesional. Ata janë të gatshëm të zgjerojnë repertorin e praktikave të tyre. Megjithatë, ata ende janë duke punuar për të kuptuar se cilat mjete funksionojnë më mirë në cilat situata dhe si të përshtatin teknologjitë digjitale me strategjitë dhe metodat pedagogjike. Integruesve u nevojitet më shumë kohë për eksperimentim dhe reflektim, të shoqëruar me inkurajim bashkëpunues dhe shkëmbim njohurish, për t'u bërë *Eksptër*.

Eksptër/Expert (B2):

Eksptërit përdorin një gamë teknologjish digjitale me vetëbesim, kreativitet dhe mendim kritik për të përmirësuar aktivitetet e tyre profesionale. Ata përzgjedhin me qëllim teknologjitë digjitale për situata të caktuara dhe përpiqen të kuptojnë përfitimet dhe kufizimet e strategjive të ndryshme digjitale. Ata janë kureshtarë dhe të hapur ndaj ideve të reja, duke ditur se ka shumë gjëra që ende nuk i kanë provuar. Ata e përdorin eksperimentimin si mjet për të zgjeruar, strukturuar dhe konsoliduar repertorin e tyre të strategjive. Eksptërit janë shtylla kurrizore e çdo institucioni arsimor kur bëhet fjalë për novacionin në praktika.

Udhëheqës/Leader (C1):

Udhëheqësit kanë një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në përdorimin e teknologjive digjitale për të përmirësuar praktikën pedagogjike dhe profesionale. Ata mbështeten në një repertor të gjerë strategjish digjitale, nga i cili dinë të zgjedhin më të përshtatshmet për çdo situatë të caktuar. Ata reflektojnë vazhdimisht mbi praktikën e tyre dhe i zhvillojnë ato më tej. Nëpërmjet shkëmbimit me kolegët, ata qëndrojnë në hap me zhvillimet dhe idetë e reja. Udhëheqësit janë burim frymëzimi për të tjerët, të cilëve ua përcjellin ekspertizën e tyre.

Pionier/Pioneer (C2):

Pionierët vënë në pikëpyetje përshtatshmërinë e praktikave digjitale dhe pedagogjike bashkëkohore, të cilat ata vetë i zotërojnë si *Udhëheqës*. Ata janë të shqetësuar për kufizimet apo mangësitë e këtyre praktikave dhe të shtyrë nga dëshira për ta çuar më tej novacionin në arsim. Pionierët eksperimentojnë me teknologji digjitale shumë novatore dhe komplekse dhe/ose zhvillojnë qasje të reja pedagogjike. Pionierët janë një kategori e veçantë dhe e rrallë. Ata udhëheqin procesin e novacionit dhe shërbejnë si model frymëzues për mësimmëdhënësit më të rinj.

Për të gjitha kompetencat, progresioni i niveleve të zotësisë është kumulativ, në kuptimin që çdo përshkrues në nivel më të lartë përfshin të gjithë përshkruesit e niveleve më të ulëta, me përjashtim të nivelit të parë, *Fillestar/Newcomer (A1)*. P.sh., të jesh *Eksptër/Expert (B2)* do të thotë të plotësosh të gjitha deklaratat nga nivelet A2 deri në B2, por jo ato të niveleve C1 dhe C2. Niveli *Fillestar/Newcomer (A1)* përshkruhet kryesisht nga mungesa e disa kompetencave, d.m.th. njohurive, aftësive ose qëndrimeve, që janë të pranishme në nivelin A2 ose më lart. Prandaj, *Eksploruesit/Explorers (A2)* janë ata që kanë kapërcyer shqetësimet ose pasiguritë e pranishme në nivelin *Fillestar/Newcomer (A1)*.

Për secilën kompetencë aplikohet një progresion specifik, në varësi nga karakteristikat e kompetencës në fjalë dhe mënyra se si ajo zakonisht evoluon drejt një niveli më të lartë zotësie. Megjithatë, disa fjalë kyç janë të përbashkëta për të njëjtin nivel zotësie në të gjitha kompetencat e një fushe të caktuar. Këto janë të shënuara në Tabelën 8.




TABELA 8: PROGRESIONI I ZOTËSISË NË DIGCOMPEDU SIPAS FUSHËS





01

Angazhimi profesional




Komunikimi organizativ

Të përdoren teknologji digjitale për të përmirësuar komunikimin organizativ me nxënësit, prindërit dhe palët e treta. Të kontribuohet në zhvillimin dhe përmirësimin e strategjive të komunikimit organizativ në mënyrë bashkëpunuese.

Aktivitete

- Të përdoren teknologji digjitale për të vënë në dispozicion resurse dhe informacione shtesë për nxënësit (dhe prindërit).
- Të përdoren teknologji digjitale për të komunikuar procedurat organizative me nxënësit dhe prindërit, p.sh. rregullat, takimet, ngjarjet.
- Të përdoren teknologji digjitale për të informuar nxënësit dhe prindërit në mënyrë individuale, p.sh. mbi progresin dhe çështjet që kërkojnë vëmendje.
- Të përdoren teknologji digjitale për të komunikuar me kolegët brenda organizatës dhe jashtë saj.
- Të përdoren teknologji digjitale për të komunikuar me palë të treta që janë relevante për projektin arsimor, p.sh. ekspertë që duhet ftuar, vende që duhet vizituar.
- Të komunikohet përmes faqes së internetit të organizatës ose përmes teknologjive digjitale, platformave ose shërbimeve të komunikimit të kontraktuara nga organizata.
- Të kontribuohet me përmbajtje në faqen e internetit të organizatës ose në mjedisin virtual të mësimnxënies.
- Të kontribuohet në zhvillimin dhe përmirësimin e strategjive të komunikimit organizativ në mënyrë bashkëpunuese.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i teknologjive digjitale për komunikim.	Unë rrallë përdor teknologjitë digjitale për komunikim.
Eksplorues (A2) 	Vetëdije dhe përdorim themelor i teknologjive digjitale për komunikim.	Unë përdor teknologji digjitale për komunikim, p.sh. me nxënësit, prindërit, kolegët ose stafin mbështetës.
Integrues (B1) 	Përdorim i teknologjive digjitale për komunikim në mënyrë efektive dhe me përgjegjësi.	Unë përdor kanale dhe mjete të ndryshme të komunikimit digjital, në varësi nga qëllimi dhe konteksti i komunikimit. Unë komunikoj me përgjegjësi dhe etikë duke përdorur teknologjitë digjitale, p.sh. duke respektuar netiketën (bontonin e internetit/teknologjisë) dhe politikat për përdorim të pranueshëm (AUP).
Ekspert (B2) 	Përdorim i teknologjive digjitale për komunikim në mënyrë të strukturuar dhe me përgjegjësi.	Unë përzgjedh kanalin, formatin dhe stilin më të përshtatshëm për një qëllim dhe kontekst të caktuar të komunikimit. Unë përshtat strategjitë e mia të komunikimit sipas audiencës specifike.
Udhëheqës (C1) 	Vlerësim dhe diskutim i strategjive të komunikimit.	Unë vlerësoj, reflektoj dhe diskutoj në mënyrë bashkëpunuese se si përdoren teknologjitë digjitale në mënyrë efektive për komunikim organizativ dhe individual. Unë përdor teknologji digjitale për të bërë procedurat administrative më transparente për nxënësit dhe/ose prindërit dhe për t'u mundësuar atyre të bëjnë zgjedhje në mënyrë të informuar (zgjedhje të bazuara) mbi prioritetet e ardhshme të mësimnxënies.
Pionier (C2) 	Reflektim dhe ri-projektim i strategjive të komunikimit.	Unë kontribuoj në zhvillimin e një vizioni ose strategjie koherente për përdorimin efektiv dhe me përgjegjësi të teknologjive digjitale për komunikim.



Bashkëpunimi profesional

Të përdoren teknologji digjitale për t'u angazhuar në bashkëpunim me mësime të tjerë, për të ndarë dhe shkëmbyer njohuri e përvoja, si dhe për të sjellë novacion në praktikën pedagogjike në mënyrë bashkëpunuese.

Aktivitetet

- Të përdoren teknologji digjitale për të bashkëpunuar me edukatorë të tjerë, në një projekt ose detyrë të caktuar.
- Të përdoren teknologji digjitale për të ndarë dhe shkëmbyer njohuri, resurse dhe përvoja me kolegët dhe bashkëpunëtorët.
- Të përdoren teknologji digjitale për të zhvilluar resurse arsimore në mënyrë bashkëpunuese.
- Të përdoren rrjete profesionale bashkëpunuese për të eksploruar dhe reflektuar mbi praktika dhe metoda të reja pedagogjike.
- Të përdoren rrjete profesionale bashkëpunuese si burim për zhvillimin profesional vetjak.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i teknologjive digjitale për bashkëpunim.	Unë rrallë përdor teknologjitë digjitale për të bashkëpunuar me kolegët.
Eksplorues (A2) 	Vetëdije dhe përdorim themelor i teknologjive digjitale për bashkëpunim.	Unë përdor teknologji digjitale për të bashkëpunuar me kolegët brenda organizatës sime, p.sh. në një projekt të përbashkët të dedikuar, ose për të shkëmbyer përmbajtje, njohuri dhe opinione.
Integrues (B1) 	Përdorim i teknologjive digjitale për të ndarë dhe shkëmbyer praktika.	Unë përdor komunitete digjitale për të eksploruar resurse ose metoda të reja pedagogjike dhe për të marrë ide të freskëta. Unë përdor teknologji digjitale për të ndarë dhe shkëmbyer resurset që përdor, njohuritë dhe opinionet e mia me kolegët brenda dhe jashtë organizatës sime.
Ekspert (B2) 	Përdorim i teknologjive digjitale për ndërtimin e njohurive në mënyrë bashkëpunuese.	Unë përdor në mënyrë aktive komunitete digjitale për të shkëmbyer ide dhe për të zhvilluar resurse digjitale në mënyrë bashkëpunuese.
Udhëheqës (C1) 	Përdorim i teknologjive digjitale për të reflektuar mbi praktikën dhe kompetencat dhe për t'i begatuar ato.	Unë përdor njohuri dhe resurse të gjeneruara në rrjetet bashkëpunuese ku bëj pjesë, për të marrë informacion kthyes (feedback) mbi kompetencat e mia, për t'i përmirësuar ato dhe për të zgjeruar repertorin tim të praktikave digjitale.
Pionier (C2) 	Përdorim i teknologjive digjitale për të lehtësuar praktika inovatore.	Unë përdor komunitete digjitale për t'u ndihmuar edukatorëve të tjerë të zhvillojnë kompetencat e tyre digjitale dhe pedagogjike. Unë përdor komunitete digjitale për të bashkëpunuar me kolegët në sjelljen e novacionit në praktikën pedagogjike.




Praktika reflektuese

Të reflektohet në nivel individual dhe kolektiv, të vlerësohet në mënyrë kritike dhe të zhvillohet në mënyrë aktive praktika digjitale pedagogjike individuale dhe e komunitetit arsimor.

Aktivitete

- ♦ Të reflektohet në mënyrë kritike mbi praktikën individuale digjitale dhe pedagogjike.
- ♦ Të identifikohen boshllëqet në kompetenca dhe fushat që kërkojnë përmirësim.
- ♦ Të kërket ndihmë nga të tjerët për të përmirësuar praktikën individuale digjitale dhe pedagogjike.
- ♦ Të kërket trajnimi i synuar dhe të shfrytëzohen mundësitë për zhvillim të vazhdueshëm profesional.
- ♦ Të synohet zgjerimi dhe begatimi i vazhdueshëm i repertorit individual të praktikave pedagogjike digjitale.
- ♦ Të ndihmohen të tjerët në zhvillimin e kompetencës së tyre pedagogjike digjitale.
- ♦ Në nivel organizativ, të reflektohet dhe të ofrohet informacion kthyes (feedback) kritik mbi politikat dhe praktikën digjitale.
- ♦ Të kontribuohet në mënyrë aktive në zhvillimin e mëtejshëm të praktikave, politikave dhe vizioneve organizative për përdorimin e teknologjive digjitale.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Pasiguri mbi nevojat e zhvillimit individual.	Unë e di që duhet të përmirësoj aftësitë e mia digjitale, por nuk jam i sigurt se si dhe nga t'ia filloj.
Eksplorues (A2) 	Vetëdije mbi nevojat e zhvillimit individual.	Unë jam i vetëdijshëm për kufijtë e kompetencës sime digjitale dhe për nevojat e mia për trajnim.
Integrues (B1) 	Përdorim i eksperimentimit dhe mësimi nga bashkëmoshatarët si burim zhvillimi.	Unë përpiqem të përmirësoj dhe të azhurnoj kompetencën time pedagogjike digjitale përmes eksperimentimit dhe mësimi nga kolegët. Unë eksperimentoj në mënyrë kreative dhe reflektoj mbi qasje të reja pedagogjike, të mundësuar nga teknologjitë digjitale.
Ekspert (B2) 	Përdorim i një game resursesh për të zhvilluar praktikë individuale digjitale dhe pedagogjike.	Unë kërkoj në mënyrë aktive praktika më të mira, kurse aftësimi ose këshilla të tjera për të përmirësuar kompetencat pedagogjike digjitale dhe kompetencat e mia digjitale më të gjera. Unë vlerësoj, reflektoj dhe diskutoj me kolegët se si të përdoren teknologjitë digjitale për të sjellë novacion dhe për të përmirësuar praktikën arsimore.
Udhëheqës (C1) 	Reflektim në mënyrë bashkëpunuese mbi praktikën pedagogjike dhe begatimin e saj në përgjithësi.	Unë ndjek kërkimet bashkëkohore mbi mësimdhënien novatore dhe integroj gjetjet e kërkimeve në praktikën time. Unë vlerësoj, reflektoj dhe diskutoj në mënyrë bashkëpunuese mbi politikat dhe praktikën organizative që lidhen me përdorimin e teknologjive digjitale. Unë ndihmoj kolegët në zhvillimin e kompetencës së tyre digjitale.
Pionier (C2) 	Novacion në politikat dhe praktikën arsimore.	Unë zhvilloj, individualisht ose në bashkëpunim me kolegët, një vizion ose strategji për përmirësimin e praktikës arsimore përmes përdorimit të teknologjive digjitale. Unë reflektoj dhe vlerësoj me kolegët dhe/ose kërkimtarët praktikën, metodat dhe politikat digjitale të ndryshme, me synimin për të zhvilluar metoda novatore.



Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZHVP/CPD)

Të përdoren burime dhe resurse digjitale për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Aktivitete

- Të përdoret interneti për të identifikuar mundësi të përshtatshme për trajnim dhe zhvillim profesional.
- Të përdoret interneti për të azhurnuar kompetencat individuale specifike për lëndën.
- Të përdoret interneti për të mësuar mbi metoda dhe strategji të reja pedagogjike.
- Të përdoret interneti për të kërkuar dhe identifikuar resurse digjitale që mbështesin zhvillimin profesional.
- Të përdoret shkëmbimi në komunitetet profesionale digjitale si burim për zhvillim profesional.
- Të përdoren mundësitë e trajnimit online, p.sh. video udhëzues (tutoriale), kurse të hapura masive online (MOOC), seminare përmes internetit (webinar) etj.
- Të përdoren teknologji dhe mjedise digjitale për të ofruar mundësi trajnimi për kolegët dhe bashkëpunëtorët.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i internetit për azhurnimin e njohurive.	Unë rrallë e hiç përdor internetin për të azhurnuar njohuritë ose aftësitë e mia.
Eksplorues (A2) 	Përdorim i internetit për azhurnimin e njohurive.	Unë përdor internetin për të azhurnuar njohuritë e mia specifike për lëndën ose ato pedagogjike.
Integrues (B1) 	Përdorim i internetit për të identifikuar mundësi për ZHVP/CPD.	Unë përdor internetin për të identifikuar kurse trajnimi të përshtatshme dhe mundësi të tjera për zhvillim profesional (p.sh. konferenca).
Ekspert (B2) 	Eksplorim i mundësive për trajnim online (ZHVP/CPD).	Unë përdor internetin për zhvillim profesional, p.sh. duke marrë pjesë në kurse online, webinare, ose duke konsultuar materiale digjitale trajnimi dhe video-udhëzues (tutoriale). Unë përdor shkëmbime formale dhe joformale në komunitetet profesionale online si burim për zhvillimin tim profesional.
Udhëheqës (C1) 	Përdorim kritik dhe strategjik i internetit për ZHVP/CPD.	Unë konsultoj një gamë mundësish të trajnimit online dhe zgjedh ato që i përshtaten më së miri nevojave të mia për zhvillim, stilit të të mësuarit dhe kufizimeve të kohës. Unë marr pjesë në mënyrë aktive në mundësi trajnimi online dhe kontribuoj për përmirësimin e tyre, duke udhëzuar të tjerët për të bërë zgjedhje të përshtatshme përmes dhënies së informacioneve kthyesë (feedback).
Pionier (C2) 	Përdorim i internetit për t'u ofruar kolegëve ZHVP/CPD.	Unë përdor teknologji digjitale për të këshilluar kolegët mbi praktikatat novatore të mësimdhënies, p.sh. në komunitete profesionale, përmes kolumnave personale në internet (blog), ose duke zhvilluar materiale digjitale trajnimi për ta.



A woman with blonde hair, wearing a dark polka-dot top and a necklace with a cross, is smiling and looking down at a laptop. She is sitting at a desk in a collaborative office environment. Other people are visible in the background, some working on laptops. The image has a green overlay.

02

Resurset digjitale




Përzgjedhja e resurseve digjitale

Të identifikohen, vlerësohen dhe përzgjidhen resurset digjitale për të mbështetur dhe begatuar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Të merren parasysh objektivi i veçantë mësimor, konteksti, qasja pedagogjike dhe grupi i nxënësve gjatë përzgjedhjes së resurseve digjitale dhe planifikimit të përdorimit të tyre.

Aktivitete

- Të formulohen strategji të përshtatshme kërkimore për të identifikuar resurse digjitale për mësimdhënie dhe mësimnxënie.
- Të zgjidhen resurse digjitale të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke marrë parasysh kontekstin specifik të mësimnxënies dhe objektivin mësimor.
- Të vlerësohet në mënyrë kritike besueshmëria dhe kredibiliteti i burimeve dhe resurseve digjitale.
- Të merren parasysh kufizimet e mundshme për përdorimin ose ripërdorimin e resurseve digjitale (p.sh. të drejtat e autorit, formati i skedarit, kërkesat teknike, dispozitat ligjore, mundësitë për qasje).
- Të vlerësohet dobia e resurseve digjitale në arritjen e objektivit të të nxënit, nivelit të kompetencës së grupit konkret të nxënësve, si dhe qasjes pedagogjike të zgjedhur.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i internetit për të gjetur resurse.	Unë rrallë e hiç përdor internetin për të resurse digjitale për mësimdhënie dhe mësimnxënie.
Eksplorues (A2) 	Vetëdije dhe përdorim themelor i teknologjive digjitale për gjetjen e resurseve.	Unë përdor strategji të thjeshta kërkimi në internet për të identifikuar përmbajtje digjitale të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Unë jam i vetëdijshëm për platformat e zakonshme arsimore që ofrojnë resurse digjitale arsimore.
Integruer (B1) 	Identifikim dhe vlerësim i resurseve të përshtatshme duke përdorur kritere themelore.	Unë përshtat strategjitë e mia të kërkimit bazuar në rezultatet që marr. Unë filtroj rezultatet për të gjetur resurse të përshtatshme, duke përdorur kritere adekuate. Unë vlerësoj cilësinë e resurseve digjitale bazuar në kritere themelore, si p.sh. vendi i publikimit, autorësia, komente nga përdorues të tjerë. Unë përzgjedh resurse që mund të jenë tërheqëse për nxënësit e mi, si p.sh. video.
Ekspert (B2) 	Identifikim dhe vlerësim i resurseve të përshtatshme duke përdorur kritere komplekse.	Unë përshtat strategjitë e mia të kërkimit për të gjetur resurse që mund të modifikoj dhe përshtat, p.sh. duke kërkuar dhe filtruar sipas licencës, zgjatimit të skedarit, datës, komenteve të përdoruesve etj. Unë gjej aplikacione dhe/ose lojëra për nxënësit e mi. Unë vlerësoj besueshmërinë e resurseve digjitale dhe përshtatshmërinë e tyre për grupin tim të nxënësve dhe objektivin specifik të të nxënësit. Unë jap informacion kthyes (feedback) dhe rekomandime mbi resurse që përdor.
Udhëheqës (C1) 	Në mënyrë gjithëpërfshirëse, identifikim dhe vlerësim i resurseve të përshtatshme, duke marrë parasysh të gjitha aspektet relevante.	Përveç motorëve të kërkimit, unë përdor një gamë burimesh të tjera, p.sh. Platforma bashkëpunuese, depozitarë zyrtarë etj. Unë vlerësoj besueshmërinë dhe përshtatshmërinë e përmbajtjes bazuar në një kombinim kriteresh, duke verifikuar gjithashtu saktësinë dhe neutralitetin e saj. Kur përdor resurse në klasë, unë i vë në kontekst për nxënësit, p.sh. duke treguar burimin dhe anshmërinë potenciale.
Pionier (C2) 	Promovim i përdorimit të resurseve digjitale në arsim.	Unë udhëzoj kolegët mbi strategjitë efektive të kërkimit dhe depozitarët dhe resurset e përshtatshme. Unë krijoj depozitar vetjak (me lidhje/links) të resurseve, të shënuara dhe të vlerësuara në mënyrë adekuate, dhe e bëj të disponueshëm për përdorim nga kolegët e tjerë.



Krijimi dhe modifikimi i resurseve digjitale

Të modifikohen dhe zhvillohen më tej resurset ekzistuese me licencë të hapur dhe resurse të tjera kur kjo lejohet. Të krijohen ose bashkë-krijohen resurse të reja arsimore digjitale. Të merren parasysh objektivi i veçantë mësimor, konteksti, qasja pedagogjike dhe grupi i nxënësve gjatë hartimit të resurseve digjitale dhe planifikimit të përdorimit të tyre.

Aktivitete

- ♦ Të modifikohen dhe të redaktohen resurse digjitale ekzistuese, kur kjo lejohet.
- ♦ Të kombinohen dhe të përzihen resurse digjitale ekzistuese ose pjesë të tyre, kur kjo lejohet.
- ♦ Të krijohen resurse të reja digjitale arsimore.
- ♦ Të krijohen bashkërisht me të tjerët resurse digjitale arsimore.
- ♦ Të merren parasysh objektivi specifik mësimor, konteksti, qasja pedagogjike dhe grupi i nxënësve, kur përshtaten ose krijohen resurse digjitale të mësimnxënies.
- ♦ Të kuptohen licencat e ndryshme që i atribuohen resurseve digjitale dhe implikimet e tyre për ripërdorim.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përmbajtje nga modifikimi i resurseve digjitale.	Unë mund të përdor resurse digjitale, por zakonisht nuk i modifikoj ato dhe as nuk krijoj resurse të mia.
Eksplorues (A2) 	Krijim dhe modifikim i resurseve duke përdorur mjete dhe strategji themelore.	Unë përdor softuerë zyre (suite office) për të projektuar dhe modifikuar, p.sh. fletë pune dhe kuize. Unë krijoj prezantime digjitale për qëllime mësimdhënieje.
Integruer (B1) 	Krijim dhe modifikim i resurseve duke përdorur disa veçori të avancuara.	Kur krijoj resurse digjitale (p.sh. prezantime), unë integroj animacione, vegëza (links), multimedia ose elemente interaktive. Unë bëj modifikime themelore në resurset digjitale që përdor, për t'i përshtatur me kontekstin mësimor, p.sh. redaktim ose fshirje pjesësh, përshtatje e cilësimeve të përgjithshme. Unë adresoj një objektiv specifik mësimor kur përzgjedh, modifikoj, kombinoj dhe krijoj resurse digjitale të mësimnxënies.
Ekspert (B2) 	Përshtatja e resurseve digjitale të avancuara në një kontekst konkret të mësimnxënies.	Unë integroj një gamë elementesh interaktive dhe lojërash në resurset e mësimdhënies që kam krijuar vetë. Unë modifikoj dhe kombinoj resurse ekzistuese për të krijuar aktivitete të mësimnxënies që janë të përshtatura për një kontekst dhe objektiv konkret mësimor, si dhe për karakteristikat e grupit të nxënësve. Unë kuptoj licencat e ndryshme që i atribuohen resurseve digjitale dhe çfarë më lejohet lidhur me modifikimin e tyre.
Udhëheqës (C1) 	Krijim, bashkë-krijim dhe modifikim i resurseve sipas kontekstit të mësimnxënies, duke përdorur një gamë strategjish të avancuara.	Unë krijoj dhe modifikoj aktivitete komplekse dhe interaktive të mësimnxënies digjitale, p.sh. fletë pune interaktive, vlerësime online, aktivitete mësimore bashkëpunuese online (p.sh. platforma bashkëpunimi tip-wiki, blog), lojëra, aplikacione, vizualizime. Unë bashkë-krijoj resurse të mësimnxënies me kolegët.
Pionier (C2) 	Krijim i resurseve digjitale komplekse dhe interaktive.	Unë krijoj aplikacione ose lojëra vetjake për të mbështetur objektivat e mia arsimore.



Menaxhimi, mbrojtja dhe ndarja e resurseve digjitale


Të organizohet përmbajtja digjitale dhe të bëhet e qasshme për nxënësit, prindërit dhe mësime të tjerë. Të mbrohet në mënyrë efektive përmbajtja digjitale e ndjeshme. Të respektohen dhe të aplikohen saktë rregullat për privatësinë dhe të drejtën e autorit. Të kuptohet përdorimi dhe krijimi i licencave të hapura dhe i resurseve arsimore të hapura, përfshirë atribuimin e tyre sipas rregullave.

Aktivitete

- Të ndahen resurse përmes vegëzave (links) ose si bashkëngjitje (attachments), p.sh. në e-mail.
- Të ndahen resurse në platforma online ose në uebsajte/ sajte tip-blog, personale ose institucionale.
- Të ndahen depozitarët personalë të resurseve me të tjerët, duke menaxhuar në mënyrë të përshtatshme qasjen dhe të drejtat e tyre.
- Të respektohen kufizimet e mundshme të të drejtave të autorit për përdorimin, ripërdorimin dhe modifikimin e resurseve digjitale.
- Të referohen sipas rregullave burimet kur ndahen ose publikohen resurse që i nënshtrohen të drejtës së autorit.
- Të atribuohen licenca (të hapura) për resurset e vetë-krijuara.
- Të merren masa për mbrojtjen e të dhënave dhe resurseve të ndjeshme (p.sh. notat e nxënësve, provimet).
- Të ndahen të dhëna administrative dhe të dhëna që lidhen me nxënësit me kolegët, nxënësit dhe prindërit, sipas nevojës.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Moszbatim i strategjive për ndarjen e resurseve.	Unë i ruaj dhe i organizoj resurset digjitale për përdorim vetjak në të ardhmen.
Eksplorues (A2) 	Menaxhim i resurseve duke përdorur strategji themelore.	Unë ndaj përmbajtje arsimore përmes bashkëngjitjeve në e-mail ose përmes vegëzave. Unë jam i vetëdijshëm se disa resurse të shpërndara në internet janë të mbrojtura me të drejta autori.
Integruues (B1) 	Shpërndarje dhe mbrojtje efektive e resurseve duke përdorur strategji themelore.	Unë ndaj përmbajtje arsimore në mjedise mësimore virtuale qoftë duke i ngarkuar (upload), duke dhënë vegëza (link) ose duke i integruar (embed) ato, p.sh. në një uebsajt kursi ose blog. Unë mbroj në mënyrë efektive përmbajtjet e ndjeshme, p.sh. provimet, raportet e nxënësve. Unë kuptoj rregullat e të drejtës së autorit që aplikohen për resurset digjitale që përdor për qëllime shkollore (imazhe, tekst, audio dhe film).
Ekspert (B2) 	Ndarje profesionale e resurseve.	Unë ndaj resurse duke i integruar ato në mjedise digjitale. Unë mbroj në mënyrë efektive të dhënat personale dhe të ndjeshme dhe kufizoj qasjen në resurse sipas nevojës. Unë i referohem në mënyrë të saktë resurseve që janë subjekt i të drejtës së autorit.
Udhëheqës (C1) 	Publikim digjital i resurseve të vetë-krijuara.	Unë përpiloj depozitarë gjithëpërfshirës të përmbajtjes digjitale dhe i bëj ata të qasshëm për nxënësit ose edukatorët e tjerë. Unë aplikoj licenca për resurset që publikoj online.
Pionier (C2) 	Publikim profesional i përmbajtjes digjitale të vetë-krijuar.	Unë përfshij shënime në resurset që ndaj në mënyrë digjitale dhe u mundësoj të tjerëve t'i komentojnë, t'i vlerësojnë, t'i modifikojnë, t'i riorganizojnë ose t'i plotësojnë ato.





03

Mësimdhënia dhe mësimnxënia




Mësimdhënia

Të planifikohen dhe implementohen pajisje dhe resurse digjitale në procesin e mësimdhënies, me qëllim të rritjes së efektivitetit të ndërhyrjeve të mësimdhënies. Të menaxhohen dhe orkestrohen në mënyrë të përshtatshme ndërhyrjet digjitale të mësimdhënies. Të eksperimentohet me, por edhe të zhvillohen, formate dhe metoda të reja pedagogjike për mësimdhënie.

Aktivitete

- Të përdoren teknologji në klasë për të mbështetur mësimdhënien, p.sh. tabelat elektronike, pajisjet mobile.
- Të strukturohet ora e mësimin në mënyrë që aktivitetet të ndryshme digjitale (të udhëhequra nga mësimdhënësi dhe të udhëhequra nga nxënësit) së bashku të përforcojnë objektivin mësimor.
- Të organizohen sesione ose orë mësimore, aktivitete dhe ndërveprime në një mjedis digjital.
- Të strukturohet dhe të menaxhohet përmbajtja, bashkëpunimi dhe ndërveprimi në një mjedis digjital.
- Të merret parasysh se si ndërhyrjet digjitale të udhëhequra nga edukatori – qofshin ato ballë për ballë apo në një mjedis digjital – mund të mbështesin më së miri objektivin mësimor.
- Të reflektohet mbi efektivitetin dhe përshtatshmërinë e strategjive pedagogjike digjitale të zgjedhura dhe të përshtaten në mënyrë fleksibël metodat dhe strategjitë.
- Të eksperimentohen me, por edhe të zhvillohen, formate dhe metoda të reja pedagogjike për mësimdhënie (p.sh. klasa e përmbysur).

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i teknologjive digjitale për mësimdhënie.	Unë nuk përdor, ose përdor shumë rrallë, pajisje digjitale apo përmbajtje digjitale në mësimdhënie.
Eksplorues (A2) 	Përdorim themelor i teknologjive digjitale për mësimdhënie.	Unë përdor teknologjitë e disponueshme të klasës, p.sh. tabelat digjitale, projektorët, kompjuterët. Unë zgjedh teknologjitë digjitale në përputhje me objektivin dhe kontekstin e mësimnxënies.
Integruues (B1) 	Integrim kuptimplotë i teknologjive të disponueshme digjitale në procesin e mësimdhënies.	Unë organizoj dhe menaxhoj integrimin e pajisjeve digjitale (p.sh. teknologjitë e klasës, pajisjet e nxënësve) në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Unë menaxhoj integrimin e përmbajtjes digjitale, p.sh. video, aktivitete interaktive, në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies.
Ekspert (B2) 	Përdorim me qëllim i teknologjive digjitale për të përmirësuar strategjitë pedagogjike.	Unë marr parasysh mjediset sociale dhe mënyrat e ndërveprimit kur integroj teknologjitë digjitale. Unë përdor teknologjitë digjitale në mësimdhënie për të shtuar diversitetin metodologjik. Unë organizoj sesione ose orë mësimore ose ndërveprime të tjera në një mjedis digjital.
Udhëheqës (C1) 	Orkestrimi, monitorimi dhe përshtatja fleksibël e përdorimit të teknologjive digjitale për të begatuar strategjitë pedagogjike.	Unë strukturoj sesionet apo orët mësimore në mënyrë që aktivitete të ndryshme digjitale (të udhëhequra nga mësimdhënësi dhe nga nxënësit) së bashku të përforcojnë objektivin mësimor. Unë strukturoj dhe menaxhoj përmbajtjen, kontributet dhe ndërveprimin në një mjedis digjital. Unë vlerësoj vazhdimisht efektivitetin e strategjive të mësimdhënies të begatuara nga aspekti digjital dhe i rishikoj ato në përputhje me nevojat.
Pionier (C2) 	Përdorim i teknologjive digjitale për të sjellë novacion në strategjitë e mësimdhënies.	Unë ofroj kurse ose module të plota të mësimore në një mjedis digjital. Unë eksperimentoj dhe zhvilloj formate dhe metoda të reja pedagogjike për mësimdhënie.



Udhëzimi

Të përdoren teknologji dhe shërbime digjitale për të forcuar ndërveprimin me nxënësit, individualisht dhe në grup, brenda dhe jashtë sesioneve apo orëve mësimore. Të përdoren teknologji digjitale për të ofruar udhëzim dhe asistencë me kohë. Të eksperimentohet me, por edhe të zhvillohen, forma dhe formate të reja për ofrimin e udhëzimit dhe mbështetjes.

Aktivitete

- Të përdoren mjete të komunikimit digjital për t'iu përgjigjur me kohë pyetjeve dhe mëdyshjeve të nxënësve, p.sh. lidhur me detyrat e shtëpisë.
- Të organizohen aktivitete mësimore në mjedise digjitale, duke parashikuar nevojat e nxënësve për udhëzim dhe duke u ofruar atyre mbështetje të përshtatshme.
- Të ndërveprohet me nxënësit në mjedise digjitale bashkëpunuese.
- Të monitorohet në mënyrë digjitale sjellja e nxënësve në klasë dhe të ofrohet udhëzim kur është e nevojshme.
- Të përdoren teknologji digjitale për të monitoruar në distancë progresin e nxënësve dhe për të ndërhyrë kur është e nevojshme, duke lejuar njëkohësisht vetë-rregullimin.
- Të eksperimentohet me, por edhe të zhvillohen, forma dhe formate të reja për ofrimin e udhëzimit dhe mbështetjes, duke përdorur teknologji digjitale.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i teknologjive digjitale për ndërveprimin me nxënësit.	Unë nuk komunikoj, ose komunikoj shumë rrallë, me nxënësit përmes mjeteve digjitale, p.sh. e-mail.
Eksplorues (A2) 	Zbatim i strategjive digjitale themelore për të ndërvepruar me nxënësit.	Unë përdor teknologjitë digjitale, p.sh. e-mail ose chat, për t'iu përgjigjur pyetjeve ose mëdyshjeve të nxënësve, p.sh. për detyrat e shtëpisë.
Integrues (B1) 	Përdorim i teknologjive digjitale për të begatuar ndërveprimin me nxënësit.	Unë përdor një kanal të përbashkët komunikimi digjital me nxënësit e mi për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe mëdyshjeve të tyre. Unë jam shpesh në kontakt me nxënësit dhe dëgjoj problemet dhe pyetjet e tyre.
Ekspert (B2) 	Përdorim i teknologjive digjitale për të begatuar monitorimin dhe udhëzimin.	Unë ndërveproj me nxënësit në mjediset bashkëpunuese digjitale që përdor, duke monitoruar sjelljen e tyre dhe duke ofruar udhëzim e mbështetje individuale, sipas nevojës. Unë eksperimentoj me forma dhe formate të reja për ofrimin e udhëzimit dhe mbështetjes, duke përdorur teknologji digjitale.
Udhëheqës (C1) 	Përdorim strategjik dhe me qëllim i teknologjive digjitale për të ofruar udhëzim dhe mbështetje.	Kur organizoj aktivitete mësimore në mjedis digjital, unë parashikoj nevojat e nxënësve për udhëzim dhe u përgjigjem atyre, p.sh. me një seksion të ndihmës apo të pyetjeve më të shpeshta (FAQ), apo me video-udhëzues (tutoriale). Kur implementoj aktivitete mësimore digjitale në klasë, unë sigurohem që mund të monitoroj (në mënyrë digjitale) sjelljen e nxënësve, ashtu që të mund të ofroj udhëzim, kur është e nevojshme.
Pionier (C2) 	Përdorim i teknologjive digjitale për të sjellë novacion në mënyrat e ofrimit të udhëzimit.	Unë zhvilloj forma dhe formate të reja për ofrimin e udhëzimit dhe mbështetjes, duke përdorur teknologji digjitale.



Mësimnxënia bashkëpunuese

Të përdoren teknologji digjitale për të nxitur dhe përforcuar bashkëpunimin ndërmjet nxënësve. T'u mundësohet nxënësve të përdorin teknologjitë digjitale si pjesë e detyrave bashkëpunuese, duke i përdorur ato si mjet për të forcuar komunikimin, bashkëpunimin dhe krijimin e njohurive në mënyrë kolektive.

Aktivitete

- Të implementohen aktivitete të mësimnxënies në mënyrë bashkëpunuese, në të cilat përdoren pajisje digjitale, resurse digjitale ose strategji të informacionit digjital.
- Të implementohen aktivitete të mësimnxënies në mënyrë bashkëpunuese në një mjedis digjital, p.sh. duke përdorur blog, wiki, apo sisteme të menaxhimit të mësimnxënies.
- Të zbatohen teknologji digjitale për shkëmbimin bashkëpunues të dijes ndërmjet nxënësve.
- Të monitorohen dhe të udhëzohen nxënësit gjatë procesit të krijimit të dijes në mënyrë bashkëpunuese në mjedis digjitale.
- Të kërkohet nga nxënësit që të prezantojnë në mënyrë digjitale përpjekjet e tyre bashkëpunuese dhe t'u ofrohet ndihmë në këtë proces.
- Të përdoren teknologji digjitale për vlerësimin nga bashkëmoshatarët dhe si mbështetje për vetë-rregullimin bashkëpunues dhe mësimnxënien nga bashkëmoshatarët.
- Të përdoren teknologji digjitale për të eksperimentuar me formate dhe metoda të reja të mësimnxënies në mënyrë bashkëpunuese.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i teknologjive digjitale në aktivitete të mësimnxënies në mënyrë bashkëpunuese.	Unë nuk marr parasysh, ose shumë rrallë marr parasysh, se si nxënësit mund të përdorin teknologji digjitale në aktivitetet apo detyrat që kryhen në mënyrë bashkëpunuese.
Eksplorues (A2) 	Inkurajim i nxënësve për të përdorur teknologji digjitale në aktivitetet që kryhen në mënyrë bashkëpunuese.	Kur implementoj aktivitete apo projekte bashkëpunuese, unë i inkurajoj nxënësit të përdorin teknologji digjitale për të mbështetur punën e tyre, p.sh. për kërkime në internet ose për prezantimin e rezultateve.
Integrues (B1) 	Implementim i teknologjive digjitale në projektimin e aktiviteteve bashkëpunuese.	Unë projektoj dhe implementoj aktivitete bashkëpunuese, në të cilat nxënësit përdorin teknologji digjitale për krijimin e dijes në mënyrë bashkëpunuese, p.sh. për gjetjen dhe shkëmbimin e informacionit. Unë u kërkoj nxënësve të dokumentojnë përpjekjet e tyre bashkëpunuese duke përdorur teknologji digjitale, p.sh. prezantime digjitale, video, postime në blog.
Ekspert (B2) 	Përdorim i mjediseve digjitale për të mbështetur mësimnxënien në mënyrë bashkëpunuese.	Unë organizoj aktivitete bashkëpunuese në një mjedis digjital, p.sh. blog, wiki, moodle, apo mjedise mësimore virtuale. Unë monitoroj dhe udhëzoj ndërveprimin bashkëpunues të nxënësve në mjedise digjitale. Unë përdor teknologji digjitale për t'u mundësuar nxënësve ndarjen e njohurive me të tjerët dhe marrjen e informacionit kthyes nga bashkëmoshatarët (peer feedback), edhe për detyra individuale.
Udhëheqës (C1) 	Përdorim i mjediseve digjitale për krijimin e dijes në mënyrë bashkëpunuese dhe për vlerësimin nga bashkëmoshatarët.	Unë projektoj dhe menaxhoj aktivitete të ndryshme të mësimnxënies në mënyrë bashkëpunuese, ku nxënësit përdorin një shumëllojshmëri teknologjish për të kryer kërkime në mënyrë bashkëpunuese, për të dokumentuar gjetjet dhe për të reflektuar mbi mësimnxënien e tyre, si në mjedise fizike ashtu edhe në ato virtuale. Unë përdor teknologji digjitale për vlerësimin nga bashkëmoshatarët dhe si mbështetje për vetë-rregullimin bashkëpunues dhe mësimnxënien nga bashkëmoshatarët.
Pionier (C2) 	Përdorim i teknologjive digjitale për të sjellë novacion në bashkëpunimin ndërmjet nxënësve.	Unë përdor teknologji digjitale për të shpikur formate të reja për mësimnxënien në mënyrë bashkëpunuese.



Mësimnxënia e vetë-rregulluar

Të përdoren teknologji digjitale për të mbështetur proceset e vetë-rregulluara të mësimnxënies, pra për t'u mundësuar nxënësve të planifikojnë, monitorojnë dhe reflektojnë mbi procesin e tyre të mësimnxënies, të ofrojnë dëshmi mbi progresin, të ndajnë përvoja dhe të ofrojnë zgjidhje kreative.

Aktivitete

- Të përdoren teknologji digjitale (p.sh. blog, ditarë, mjete planifikimi) për t'u mundësuar nxënësve të planifikojnë procesin e tyre të mësimnxënies.
- Të përdoren teknologji digjitale për t'u mundësuar nxënësve të mbledhin dëshmi dhe të regjistrojnë progresin e tyre, p.sh. incizime audio ose video, fotografi.
- Të përdoren teknologji digjitale (p.sh. ePortfolio, blog i nxënësve) për t'u mundësuar nxënësve të regjistrojnë dhe të prezantojnë punën e tyre.
- Të përdoren teknologji digjitale për t'u mundësuar nxënësve të reflektojnë dhe të vetë-vlerësojnë procesin e tyre të mësimnxënies.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i teknologjive digjitale për mësimnxënie në mënyrë të vetë-rregulluar.	Unë nuk marr parasysh, ose shumë rrallë marr parasysh, se si nxënësit mund të përdorin teknologji digjitale në aktivitetet apo detyrat që kryhen në mënyrë të vetë-rregulluar.
Eksplorues (A2) 	Inkurajim i nxënësve për të përdorur teknologji digjitale në aktivitetet që kryhen për mësimnxënie në mënyrë të vetë-rregulluar.	Unë i inkurajoj nxënësit të përdorin teknologji digjitale për të mbështetur aktivitetet dhe detyrat e tyre individuale të mësimnxënies, p.sh. për nxjerrje informacioni ose për prezantimin e rezultateve.
Integruues (B1) 	Implementim i teknologjive digjitale në projektimin e aktiviteteve të mësimnxënies së vetë-rregulluar.	Unë i inkurajoj nxënësit të përdorin teknologji digjitale për të mbledhur dëshmi dhe për të regjistruar progresin e tyre, p.sh. për prodhimin e regjistrimeve audio ose video, fotografive, teksteve. Unë përdor teknologji digjitale (p.sh. ePortofolio, blog i nxënësve) për t'u mundësuar nxënësve të regjistrojnë dhe të prezantojnë punën e tyre. Unë përdor teknologji digjitale për vetë-vlerësimin e nxënësve.
Ekspert (B2) 	Përdorim i mjediseve digjitale për të mbështetur në mënyrë gjithëpërfshirëse proceset e vetë-rregulluara të mësimnxënies.	Unë përdor teknologji ose mjedise digjitale (p.sh. ePortofolio, blog, ditarë, mjete planifikimi) për t'u mundësuar nxënësve të menaxhojnë dhe dokumentojnë të gjitha fazat e mësimnxënies së tyre, p.sh. për planifikim, nxjerrje informacioni, dokumentim, reflektim dhe vetë-vlerësim. Unë ndihmoj nxënësit në zhvillimin, aplikimin dhe rishikimin e kriterëve të përshtatshme për vetë-vlerësim, me mbështetjen e teknologjive digjitale.
Udhëheqës (C1) 	Reflektim kritik mbi strategjitë digjitale që përdoren për të nxitur proceset e vetë-rregulluara të mësimnxënies.	Unë reflektoj mbi përshtatshmërinë e strategjive të mia digjitale në promovimin e mësimnxënies së vetë-rregulluar dhe begatoj vazhdimisht strategjitë e mia.
Pionier (C2) 	Zhvillim i formateve të reja digjitale dhe/ose qasjeve pedagogjike për të nxitur mësimnxënien e vetë-rregulluar.	Unë zhvilloj formate dhe/ose qasje pedagogjike të reja digjitale për të nxitur mësimnxënien e vetë-rregulluar.



A photograph of two female students in a library. The student on the left is smiling and looking down at a book. The student on the right is wearing glasses and looking towards the camera. They are both wearing school uniforms. The background shows bookshelves filled with books. The image has a teal overlay with geometric shapes.

04

Vlerësimi




Strategjitë e vlerësimit

Të përdoren teknologji digjitale për vlerësimin formativ dhe sumativ. Të përmirësohet diversiteti dhe përshtatshmëria e formateve dhe qasjeve ndaj vlerësimit.

Aktivitete

- ♦ Të përdoren mjete vlerësimi digjital për të monitoruar procesin e mësimnxënies dhe për të siguruar informacione mbi progresin e nxënësve.
- ♦ Të përdoren teknologji digjitale për të begatuar strategjitë e vlerësimit formativ, p.sh. duke përdorur sisteme të përgjigjes në klasë, kuize, lojëra.
- ♦ Të përdoren teknologji digjitale për të begatuar vlerësimin sumativ në teste, p.sh. përmes testeve të bazuara në kompjuter, duke integruar audio ose video (p.sh. në mësimnxënie të gjuhës), si dhe përmes përdorimit të simulimeve ose teknologjive digjitale të specializuara sipas lëndës si mjedise testimi.
- ♦ Të përdoren teknologji digjitale për të zbërthyer detyrat dhe vlerësimin e nxënësve, me përshkallëzim, duke u ofruar më pak mbështetje në mënyrë graduale, p.sh. përmes portofolave elektronike (ePortfolios).
- ♦ Të përdoret një gamë e gjerë formatesh vlerësimi, digjitale dhe jo-digjitale, duke qenë të vetëdijshëm për përfitimet dhe kufizimet e tyre.
- ♦ Të reflektohet në mënyrë kritike mbi përshtatshmërinë e qasjeve të vlerësimit digjital dhe të përshtaten strategjitë përkatëse në përputhje me rrethanat.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i teknologjive digjitale për vlerësim.	Unë nuk i përdor, ose i përdor shumë rrallë, formatet e vlerësimit digjital.
Eksplorues (A2) 	Integrim i teknologjive digjitale në strategjitë tradicionale të vlerësimit.	Unë përdor teknologjitë digjitale për të krijuar detyra vlerësimi, të cilat më pas administrohen në format të shtypur. Unë planifikoj përdorimin e teknologjive digjitale nga nxënësit në detyra vlerësimi, p.sh. si mbështetje për detyrat.
Integruues (B1) 	Përdorim dhe modifikim i mjeteve dhe formateve ekzistuese të vlerësimit digjital.	Unë përdor disa nga teknologjitë ekzistuese digjitale për vlerësim formativ ose sumativ, p.sh. kuize digjitale, e-portfolio, lojëra. Unë përshtat mjete vlerësimi digjital për të mbështetur qëllimin tim të veçantë të vlerësimit, p.sh. krijoj një test duke përdorur një sistem testimi digjital.
Ekspert (B2) 	Përdorim strategjik i një game të gjerë formatesh vlerësimi digjital.	Unë përdor një gamë programesh (softuerike), mjeteve dhe qasjes vlerësimi elektronik, për vlerësimin formativ, si brenda klasës ashtu edhe për përdorim nga nxënësit jashtë shkollës. Unë përzgjedh ndërmjet formateve të ndryshme të vlerësimit atë që kap më së miri natyrën e rezultatit të mësimnxënies që duhet të vlerësohet. Unë projektoj vlerësime digjitale që janë të vlefshme dhe të besueshme.
Udhëheqës (C1) 	Përzgjedhje, krijim dhe përshtatje gjithëpërfshirëse dhe kritike e formateve të vlerësimit digjital.	Unë përdor një shumëllojshmëri formatesh vlerësimi, digjitale dhe jo-digjitale, të përafruara me standardet e përmbajtjes dhe të teknologjisë, duke qenë i vetëdijshëm për përfitimet dhe kufizimet e tyre. Unë reflektoj në mënyrë kritike mbi përdorimin tim të teknologjive digjitale për vlerësim dhe përshtat strategjitë e mia në përputhje me to.
Pionier (C2) 	Zhvillim i formateve novatore të vlerësimit, duke përdorur teknologji digjitale.	Unë zhvilloj formate të reja digjitale për vlerësim, të cilat pasqyrojnë qasje pedagogjike novatore dhe mundësojnë vlerësimin e aftësive ndërdisiplinore.



Analizimi i dëshmimeve

Të gjenerohen, përzgjidhen, analizohen dhe interpretohen në mënyrë kritike dëshmitë digjitale mbi aktivitetin, performancën dhe progresin e nxënësve, me qëllim informimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Aktivitete

- Të projektohen dhe të implementohen aktivitete të mësimnxënies që gjenerojnë të dhëna mbi aktivitetin dhe performancën e nxënësve.
- Të përdoren teknologji digjitale për të regjistruar, krahasuar dhe sintetizuar të dhënat mbi progresin e nxënësve.
- Të qenët të vetëdijshëm se aktiviteti i nxënësve në mjedis digjitale gjeneron të dhëna që mund të përdoren për të informuar (për të marrë vendime të bazuara mbi) mësimdhënien dhe mësimnxënien.
- Të analizohen dhe interpretohen dëshmitë e disponueshme mbi aktivitetin dhe progresin e nxënësve, duke përfshirë edhe të dhënat e gjeneruara nga teknologjitë digjitale që përdoren.
- Të merren parasysh, të kombinohen dhe të vlerësohen burime të ndryshme dëshmish mbi progresin dhe performancën e nxënësve.
- Të vlerësohen në mënyrë kritike dëshmitë e disponueshme për të informuar (për të marrë vendime të bazuara mbi) mësimdhënien dhe mësimnxënien.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i të dhënave digjitale për monitorimin e progresit.	Unë nuk i referohem, ose i referohem shumë rrallë, të dhënave të regjistruara në mënyrë digjitale për të kuptuar nivelin ku ndodhen nxënësit e mi.
Eksplorues (A2) 	Vlerësim i të dhënave themelore mbi aktivitetin dhe performancën e nxënësve.	Unë vlerësoj të dhënat administrative (p.sh. vijueshmëria) dhe të dhënat mbi performancën e nxënësve (p.sh. notat) për të ofruar informacion kthyes (feedback) individual dhe ndërhyrje të synuara. Jam i vetëdijshëm se mjete vlerësimi digjital (p.sh. kuize, sisteme votimi) mund të përdoren brenda procesit të mësimdhënies për të më ofruar informacion kthyes (feedback) me kohë mbi progresin e nxënësve.
Integrues (B1) 	Vlerësim i një game të të dhënave digjitale për të informuar (për të marrë vendime të bazuara mbi) mësimdhënien.	Unë vlerësoj të dhënat që rezultojnë nga vlerësimet digjitale për të informuar (për të marrë vendime të bazuara mbi) mësimnxënien dhe mësimdhënien. Jam i vetëdijshëm se të dhënat mbi aktivitetin e nxënësve, ashtu siç regjistrohen në mjediset digjitale që unë përdor me ta, mund të më ndihmojnë të monitoroj progresin e tyre dhe t'u ofroj informacion kthyes (feedback) dhe mbështetje me kohë.
Ekspert (B2) 	Përdorim strategjik i mjeteve digjitale për gjenerimin e të dhënave.	Unë përdor teknologji digjitale (p.sh. kuize, sisteme votimi) brenda procesit të mësimdhënies për të më ofruar informacion kthyes (feedback) me kohë mbi progresin e nxënësve. Unë përdor mjete të analizës së të dhënave që ofrohen nga mjediset digjitale që përdor, për të monitoruar dhe vizualizuar aktivitetin. Unë interpretoj të dhënat dhe dëshmitë e disponueshme për të kuptuar më mirë nevojat individuale të nxënësve për mbështetje.
Udhëheqës (C1) 	Përdorim i të dhënave digjitale për reflektim mbi modelet e mësimnxënies dhe strategjitë e mësimdhënies.	Unë monitoroj vazhdimisht aktivitetin digjital dhe reflektoj rregullisht mbi të dhënat e regjistruara të nxënësve për të identifikuar dhe adresuar me kohë sjelljet kritike dhe problemet individuale. Unë vlerësoj dhe sintetizoj të dhënat e gjeneruara nga teknologjitë e ndryshme digjitale që përdor, për të reflektuar mbi efektivitetin dhe përshtatshmërinë e strategjive të ndryshme të mësimdhënies dhe aktiviteteve të mësimnxënies, si në përgjithësi, ashtu edhe për grupe të caktuara nxënësish.
Pionier (C2) 	Novacion në gjenerimin dhe vlerësimin e të dhënave.	Unë implementoj metoda të avancuara të gjenerimit dhe vizualizimit të të dhënave në aktivitetet digjitale që zbatoj, p.sh. bazuar në analitikën e të nxënësve (learning analytics). Unë vlerësoj dhe diskutoj në mënyrë kritike vlefshmërinë dhe besueshmërinë e burimeve të ndryshme të të dhënave, si dhe përshtatshmërinë e metodave të pranura për analizën e të dhënave.



Informacioni kthyes (feedback) dhe planifikimi

Të përdoren teknologji digjitale për t'u ofruar nxënësve informacion kthyes (feedback) në mënyrë të synuar dhe me kohë. Të përshtaten strategjitë e mësimdhënies dhe të ofrohet mbështetje në mënyrë të synuar, bazuar në dëshmitë e gjeneruara nga teknologjitë digjitale që përdoren. T'u mundësohet nxënësve dhe prindërve të kuptojnë dëshmitë e ofruara nga teknologjitë digjitale dhe t'i përdorin ato për marrjen e vendimeve.

Aktivitete

- Të përdoren teknologji digjitale për të vlerësuar (me notë) dhe për të dhënë informacion kthyes (feedback) mbi detyrat e dorëzuara në mënyrë elektronike.
- Të përdoren sisteme menaxhimi të vlerësimit për të rritur efektivitetin e ofrimit të informacioneve kthyes (feedback).
- Të përdoren teknologji digjitale për të monitoruar progresin e nxënësve dhe për të ofruar mbështetje kur është e nevojshme.
- Të përshtaten praktikatat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, bazuar në të dhënat e gjeneruara nga teknologjitë digjitale që përdoren.
- Të ofrohet informacion kthyes (feedback) personal dhe mbështetje e diferencuar për nxënësit, bazuar në të dhënat e gjeneruara nga teknologjitë digjitale që përdoren.
- Të mundësohet që nxënësit të vlerësojnë dhe interpretojnë rezultatet e vlerësimeve formative, sumative, vetë-vlerësimeve dhe vlerësimeve nga bashkëmoshatarët.
- Të ndihmohen nxënësit në identifikimin e fushave për përmirësim dhe të zhvillohen së bashku plane mësimnxënije për adresimin e këtyre fushave.
- Të përdoren teknologji digjitale për të mundësuar që nxënësit dhe/ose prindërit të jenë të informuar mbi progresin dhe të marrin vendime në mënyrë të informuar (të bazuara) mbi prioritetet e ardhshme të mësimnxënies, lëndët zgjedhore ose studimet e mëtejshme.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i të dhënave digjitale për informacion kthyes (feedback) dhe planifikim.	Unë nuk jam i vetëdijshëm se si teknologjitë digjitale mund të më ndihmojnë në dhënien e informacioneve kthyes (feedback) për nxënësit ose në përshtatjen e strategjive të mia të mësimdhënies.
Eksplorues (A2) 	Përdorim i teknologjive digjitale për të informuar (për të marrë vendime të bazuara mbi) dhënien e komenteve (feedback).	Unë përdor teknologji digjitale për të përpiluar një pasqyrë mbi progresin e nxënësve, të cilën e përdor si bazë për të ofruar informacion kthyes dhe këshilla.
Integruer (B1) 	Përdorim i teknologjive digjitale për dhënien e informacioneve kthyes (feedback).	Unë përdor teknologji digjitale për të vlerësuar dhe dhënë informacion kthyes (feedback) mbi detyrat e dorëzuara në mënyrë elektronike. Unë ndihmoj nxënësit dhe/ose prindërit të kenë qasje në informacion mbi performancën e nxënësve, duke përdorur teknologjitë digjitale.
Ekspert (B2) 	Përdorim i të dhënave digjitale për të rritur efektivitetin e informacioneve kthyes (feedback) dhe mbështetjes.	Unë përshtat praktikën e mia të mësimdhënies dhe të vlerësimit, bazuar në të dhënat e gjeneruara nga teknologjitë digjitale që përdor. Unë ofroj informacion kthyes (feedback) personal dhe mbështetje të diferencuar për nxënësit, bazuar në të dhënat e gjeneruara nga teknologjitë digjitale që përdor. Unë përdor teknologji digjitale për të mundësuar që nxënësit dhe/ose prindërit të jenë të informuar mbi progresin dhe të marrin vendime në mënyrë të informuar (të bazuara) mbi prioritetet e ardhshme të mësimnxënies, lëndët zgjedhore ose studimet e mëtejshme.
Udhëheqës (C1) 	Përdorim i teknologjive digjitale për personalizimin e informacionit kthyes (feedback) dhe mbështetjes.	Unë ndihmoj nxënësit në identifikimin e fushave për përmirësim dhe në zhvillimin e përbashkët të planeve të mësimnxënies për adresimin e këtyre fushave. Unë përdor të dhënat e gjeneruara nga teknologjitë digjitale për të reflektuar se cilat strategji të mësimdhënies funksionojnë më mirë për kategori të ndryshme nxënësish dhe i përshtat strategjitë e mia përkatësisht.
Pionier (C2) 	Përdorim i të dhënave digjitale për të vlerësuar dhe përmirësuar mësimdhënien.	Unë reflektoj, diskutoj, ri-projektoj dhe sjell novacion në strategjitë e mësimdhënies për t'u dalë ndesh dështimeve digjitale që identifikoj, në lidhje me preferencat dhe nevojat e nxënësve, si dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të ndryshme të mësimdhënies dhe formateve të mësimnxënies.





05

Fuqizimi i nxënësve



Qasja dhe përfshirja

Të sigurohet qasja në resurse dhe aktivitete mësimore për të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevoja të veçanta. Të merren parasysh dhe të adresohen pritshmëritë, aftësitë, përdorimet dhe keqkuptimet (digjitale) të nxënësve, si dhe kufizimet kontekstuale, fizike ose njohëse në përdorimin e teknologjive digjitale.

Aktivitete

- Të ofrohet qasje e barabartë në teknologji dhe resurse digjitale përkatëse, p.sh. duke u siguruar që të gjithë nxënësit të kenë qasje në teknologjitë digjitale që përdoren.
- Të përzgjidhen dhe të zbatohen strategji pedagogjike digjitale që i përgjigjen kontekstit digjital të nxënësve, p.sh. kufizimeve kontekstuale në përdorimin e teknologjisë (p.sh. disponueshmëria), kompetencave, pritshmërive, qëndrimeve, keqkuptimeve dhe përdorimeve të gabuara.
- Të përdoren teknologji dhe strategji digjitale, p.sh. teknologjitë ndihmuese, të projektuara për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje të veçantë (p.sh. nxënës me kufizime fizike ose mendore; nxënës me çrregullime të të nxënës).
- Të merren parasysh dhe të adresohen çështjet e mundshme të qasjes gjatë përzgjedhjes, modifikimit ose krijimit të resurseve digjitale dhe të ofrohen mjete ose qasje alternative ose kompensuese për nxënësit me nevoja të veçanta.
- Të zbatohen parime projektimi për rritjen e qasjes në resurse dhe mjedise digjitale që përdoren në mësimdhënie.
- Të monitorohet dhe të reflektohet në mënyrë të vazhdueshme mbi përshtatshmërinë e masave të implementuara për përmirësimin e qasjes dhe të përshtaten strategjitë përkatëse.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Të qenët i shqetësuar për qasjen dhe përfshirjen.	Unë kam frikë se përdorimi i teknologjive digjitale në mësimdhënie do ta bëjë edhe më të vështirë për nxënësit që tashmë janë të pafavorizuar të marrin pjesë dhe të ecin përpara me të tjerët.
Eksplorues (A2) 	Të qenët i vetëdijshëm për çështjet e qasjes dhe përfshirjes.	Unë e kuptoj rëndësinë e sigurimit të qasjes së barabartë në teknologji digjitale që përdoren nga të gjithë nxënësit. Unë jam i vetëdijshëm se teknologjitë digjitale mund të pengojnë ose të përmirësojnë qasjen.
Integruues (B1) 	Adresim i qasjes dhe përfshirjes.	Unë e kuptoj se si qasja në teknologji digjitale krijon ndasi dhe se si kushtet sociale dhe ekonomike të nxënësve ndikojnë në mënyrën se si përdoret teknologjia. Unë sigurohem që të gjithë nxënësit të kenë qasje në teknologjitë digjitale që përdor. Unë jam i vetëdijshëm se mund të përdoren teknologji digjitale kompensuese për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje të veçantë (p.sh. nxënës me kufizime fizike ose mendore; nxënës me çrregullime të të nxënës).
Ekspert (B2) 	Mundësim i qasjes dhe përfshirjes.	Unë përzgjedh strategji pedagogjike digjitale që përshtaten me kontekstet digjitale të nxënësve, p.sh. kohën e kufizuar të përdorimit, llojin e pajisjes në dispozicion. Unë marr parasysh dhe adresoj çështjet e mundshme të qasjes gjatë përzgjedhjes, modifikimit ose krijimit të resurseve digjitale dhe ofroj mjete ose qasje alternative ose kompensuese për nxënësit me nevoja të veçanta. Unë përdor teknologji dhe strategji digjitale, p.sh. teknologjitë ndihmuese, për të trajtuar problemet individuale të nxënësve me qasje, p.sh. dëmtimet e shikimit ose të dëgjimit.
Udhëheqës (C1) 	Avancim i qasjes dhe përfshirjes.	Unë përzgjedh dhe zbatoj strategji pedagogjike digjitale të përshtatura me mënyrat e përdorimit të teknologjisë digjitale nga nxënësit, kompetencat, pritshmëritë, qëndrimet, keqkuptimet dhe përdorimet e gabuara të tyre. Unë zbatoj parime projektimi për rritjen e qasjes në resurse dhe mjedise digjitale që përdor në mësimdhënie, p.sh. për sa i përket shkronjave, madhësisë, ngjyrave, gjuhës, paraqitjes, strukturës. Unë monitoroj dhe reflektoj vazhdimisht mbi përshtatshmërinë e masave të implementuara për përmirësimin e qasjes dhe i përshtat strategjitë e mia përkatësisht.
Pionier (C2) 	Novacion në strategjitë për qasje dhe përfshirje.	Unë reflektoj, diskutoj, ri-projektoj dhe sjell novacion në strategjitë për qasje të barabartë dhe përfshirje në arsimin digjital.



Diferencimi dhe personalizimi

Të përdoren teknologji digjitale për të adresuar nevojat e ndryshme mësimore të nxënësve, duke mundur që ata të avancojnë në nivele dhe shpejtësi të ndryshme, dhe të ndjekin rrugë dhe objektiva mësimore individuale.

Aktivitete

- ♦ Të përdoren teknologji digjitale për adresimin e nevojave të veçanta të nxënësve individualë (p.sh. disleksia, ADHD, nxënësit mbi-mesatarë).
- ♦ Të mundësohen rrugë të ndryshme mësimnxënieje, nivele dhe shpejtësi të ndryshme gjatë projektimit, përzgjedhjes dhe implementimit të aktiviteteve digjitale të mësimnxënies.
- ♦ Të hartohen plane individuale të mësimnxënies dhe të përdoren teknologji digjitale për t'i mbështetur ato.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Të qenët i pasigurt në lidhje me potencialin e teknologjive digjitale për diferencim dhe personalizim.	Unë nuk e di se si teknologjitë digjitale mund të më ndihmojnë të ofroj mundësi të personalizuar për mësimnxënie.
Eksplorues (A2) 	Të qenët i vetëdijshëm për potencialin e teknologjive digjitale për diferencim dhe personalizim.	Jam i vetëdijshëm se teknologjitë digjitale mund të mbështesin diferencimin dhe personalizimin, p.sh. duke ofruar aktivitete në nivele dhe shpejtësi të ndryshme.
Integrues (B1) 	Përdorim i teknologjive digjitale për diferencim dhe personalizim.	Unë përzgjedh dhe përdor disa aktivitete mësimore, p.sh. kuize ose lojëra, të cilat u mundësojnë nxënësve të ecin me shpejtësi të ndryshme, të zgjedhin nivele të ndryshme të vështirësisë dhe/ose të përsërisin aktivitete që nuk i kanë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme më parë.
Ekspert (B2) 	Përdorim në mënyrë strategjike i një game teknologjish digjitale për diferencim dhe personalizim.	Gjatë projektimit të aktiviteteve të mësimnxënies dhe të vlerësimit, unë përdor një gamë të ndryshme teknologjish digjitale, të cilat i përshtat dhe i rregulloj për të marrë parasysh nevojat, nivele, ritme dhe preferenca të ndryshme. Gjatë renditjes dhe implementimit të aktiviteteve mësimore, unë mundësoj rrugë të ndryshme të mësimnxënies, nivele dhe ritme të ndryshme dhe i përshtat në mënyrë fleksibël strategjitë e mia sipas rrethanave ose nevojave në ndryshim.
Udhëheqës (C1) 	Implementim gjithëpërfshirës dhe kritik i mësimnxënies së diferencuar dhe të personalizuar.	Unë projektoj, në bashkëpunim me nxënësit dhe/ose prindërit, plane të personalizuar të mësimnxënies, të cilat u mundësojnë të gjithë nxënësve të ndjekin nevojat dhe preferencat e tyre individuale për mësimnxënie, duke përdorur resurse digjitale përkatëse. Unë reflektoj mbi efektivitetin e strategjive të mësimdhënies të zbatuara në nxitjen e diferencimit dhe personalizimit dhe përshtat strategjitë e mia të mësimdhënies dhe aktivitetet digjitale në përputhje me to.
Pionier (C2) 	Novacion në strategjitë për diferencim dhe personalizim, përmes përdorimit të teknologjive digjitale.	Unë reflektoj, diskutoj, ri-projektoj dhe sjell novacion në strategjitë pedagogjike për personalizim të arsimit, përmes përdorimit të teknologjive digjitale.



Angazhimi aktiv i nxënësve


Të përdoren teknologji digjitale për të nxitur angazhimin aktiv dhe kreativ të nxënësve me lëndën përkatëse. Të përdoren teknologji digjitale brenda strategjive pedagogjike që zhvillojnë aftësitë transversale të nxënësve, mendimin e thellë dhe shprehjen kreative. Të hapet procesi i mësimnxënies ndaj konteksteve të reja nga bota reale, duke përfshirë nxënësit në aktivitete praktike, hulumtime shkencore ose zgjidhje problemesh komplekse, apo në mënyra të tjera që rrisin përfshirjen aktive të nxënësve në lëndë komplekse.

Aktivitete

- ◆ Të përdoren teknologji digjitale për të vizualizuar dhe shpjeguar koncepte të reja në mënyrë motivuese dhe angazhuese, p.sh. përmes zbatimit të animacioneve ose videove.
- ◆ Të zbatohen mjedise apo aktivitete të mësimnxënies digjitale që janë motivuese dhe angazhuese, p.sh. lojëra, kuize.
- ◆ Të vendoset përdorimi aktiv i teknologjive digjitale nga nxënësit në qendër të procesit të mësimdhënies.
- ◆ Të përdoren teknologji digjitale për t'u mundësuar nxënësve të angazhohen në mënyrë aktive me lëndën përkatëse, p.sh. duke përdorur shqisat e ndryshme, duke manipuluar objekte virtuale, ose duke ndryshuar strukturën e problemit për të hetuar ndërtimin e tij, etj.
- Të përzgjidhen teknologji digjitale të përshtatshme për nxitjen e mësimnxënies aktive në një kontekst të caktuar të mësimnxënies ose për një objektiv specifik të mësimnxënies.
- Të reflektohet mbi përshtatshmërinë e teknologjive digjitale që përdoren për rritjen e mësimnxënies aktive të nxënësve dhe të përshtaten strategjitë dhe zgjedhjet në përputhje me këtë.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i teknologjive digjitale për angazhimin e nxënësve.	Unë rrallë e hiç përdor teknologji digjitale për motivimin apo angazhimin e nxënësve.
Eksplorues (A2) 	Përdorim i teknologjive digjitale për angazhimin e nxënësve.	Unë përdor teknologji digjitale për të vizualizuar dhe shpjeguar koncepte të reja në mënyrë motivuese dhe angazhuese, p.sh. përmes zbatimit të animacioneve ose videove. Unë zbatoj aktivitete të mësimnxënies digjitale që janë motivuese dhe angazhuese, p.sh. lojëra, kuize.
Integrues (B1) 	Nxitje e përdorimit aktiv të teknologjive digjitale nga nxënësit.	Unë vendos përdorimin aktiv të teknologjive digjitale nga nxënësit në qendër të procesit të mësimdhënies. Unë përzgjedh mjetin më të përshatshëm për nxitjen e angazhimit aktiv në një kontekst të caktuar të mësimnxënies ose për një objektiv specifik të mësimnxënies.
Ekspert (B2) 	Përdorim i teknologjive digjitale për angazhimin aktiv të nxënësve me lëndën mësimore.	Unë përdor një gamë të gjerë teknologjish digjitale për të krijuar një mjedis të pasur, përkatës dhe efektiv të mësimnxënies digjitale, p.sh. duke shfrytëzuar kanale të ndryshme shqisore, stile dhe strategji të ndryshme të mësimnxënies, duke ndryshuar në mënyrë metodologjike llojet e aktiviteteve dhe përbërjen e grupeve. Unë reflektoj mbi efektivitetin e strategjive të mësimdhënies që zbatohen për të rritur angazhimin dhe mësimnxënien aktive të nxënësve.
 Udhëheqës (C1)	Implementim gjithëpërfshirës dhe kritik i strategjive për mësimnxënie aktive.	Unë përzgjedh, projektoj, zbatoj dhe orkestroj përdorimin e teknologjive digjitale brenda procesit të mësimnxënies, duke marrë parasysh potencialin e tyre për të nxitur angazhimin aktiv, kreativ dhe kritik të nxënësve me lëndën mësimore. Unë reflektoj mbi përshtatshmërinë e teknologjive digjitale që përdoren për rritjen e mësimnxënies aktive të nxënësve dhe përshtat strategjitë dhe zgjedhjet e mia në përputhje me këtë.
 Pionier (C2)	Novacion në strategjitë digjitale për mësimnxënie aktive.	Unë reflektoj, diskutoj, ri-projektoj dhe sjell novacion në strategjitë pedagogjike për angazhimin aktiv të nxënësve.



The background image shows a library setting with bookshelves filled with books. In the foreground, a young woman with blonde hair and black-rimmed glasses is looking towards the left. Behind her, a young man is partially visible, also looking in the same direction. The entire image is covered with a semi-transparent red overlay. A large, dark red geometric shape, resembling a stylized 'X' or a large triangle, is positioned in the lower right corner, partially obscuring the text and the background image.

06

Lehtësimi i zhvillimit të kompetencës digjitale të nxënësve



Kultura e informacionit dhe mediave

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të artikulojnë nevojat për informacion; të gjejnë informacion dhe resurse në mjedise digjitale; të organizojnë, përpunojnë, analizojnë dhe interpretojnë informacionin; dhe të krahasojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike besueshmërinë dhe kredibilitetin e informacionit dhe burimeve të tij.

Aktivitete

Të përfshihen aktivitete të mësimnxënies, detyra dhe vlerësime të cilat nxisin dhe kërkojnë nga nxënësit:

- ♦ Të artikulojnë nevojat për informacion, të kërkojnë të dhëna, informacion dhe përmbajtje në mjedise digjitale, t'u qasen atyre dhe të kalojnë nga njëra në tjetrën.
- ♦ Të krijojnë dhe azhurnojnë strategji personale të kërkimit.
- ♦ Të përshtatin strategjitë e kërkimit bazuar në cilësinë e informacionit të gjetur.
- Të analizojnë, krahasojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e burimeve të të dhënave, informacionit dhe përmbajtjes digjitale.
- Të organizojnë, ruajnë dhe nxjerrin të dhëna, informacion dhe përmbajtje në mjedise digjitale.
- Të organizojnë dhe përpunojnë informacionin në një mjedis të strukturuar.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i strategjive për nxitjen e kulturës së informacionit te nxënësit.	Unë nuk marr parasysh, ose marr parasysh vetëm shumë rrallë, mënyra se si mund të nxis kulturën e informacionit dhe të mediave te nxënësit.
Eksplorues (A2) 	Inkurajim i nxënësve që të përdorin teknologji digjitale për nxjerrjen e informacionit.	Unë i inkurajoj nxënësit të përdorin teknologji digjitale për nxjerrjen e informacionit, p.sh. në kuadër të detyrave.
Integruues (B1) 	Implementim i aktiviteteve që nxisin kulturën e informacionit dhe të mediave te nxënësit.	Unë implementoj aktivitete të mësimnxënies në të cilat nxënësit përdorin teknologjitë digjitale për nxjerrjen e informacionit. Unë i mësoj nxënësit si të gjejnë informacionin, si të vlerësojnë besueshmërinë e tij, si të krahasojnë dhe kombinojnë informacionin nga burime të ndryshme.
Ekspert (B2) 	Përdorim strategjik i një game të gjerë strategjish pedagogjike për nxitjen e kulturës së informacionit dhe të mediave te nxënësit.	Unë përdor një gamë strategjish të ndryshme pedagogjike për t'u mundësuar nxënësve të krahasojnë në mënyrë kritike dhe të kombinojnë në mënyrë kuptimplotë informacionin nga burime të ndryshme. Unë i mësoj nxënësit si të citojnë burimet sipas rregullave.
Udhëheqës (C1) 	Nxitje gjithëpërfshirëse dhe kritike e kulturës së informacionit dhe të mediave te nxënësit.	Unë reflektoj në mënyrë kritike mbi përshtatshmërinë e strategjive të mia pedagogjike për nxitjen e kulturës së informacionit dhe të mediave te nxënësit dhe përshtat strategjitë e mia në përputhje me këtë.
Pionier (C2) 	Përdorim i formateve novatore për nxitjen e kulturës së informacionit dhe të mediave te nxënësit.	Unë reflektoj, diskutoj, ri-projektoj dhe sjell novacion në strategjitë pedagogjike për nxitjen e kulturës së informacionit dhe të mediave te nxënësit.




Komunikimi dhe bashkëpunimi digjital

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të përdorin teknologjitë digjitale në mënyrë efektive dhe me përgjegjësi për komunikim, bashkëpunim dhe pjesëmarrje qytetare.

Aktivitete

Të përfshihen aktivitete të mësimnxënies, detyra dhe vlerësime të cilat nxisin dhe kërkojnë nga nxënësit:

- ♦ Të ndërveprojnë përmes një varg teknologjish digjitale.
- ♦ Të kuptojnë mjetet përkatëse të komunikimit digjital në një kontekst të caktuar.
- ♦ Të ndajnë të dhëna, informacion dhe përmbajtje digjitale me të tjerët përmes teknologjive digjitale të përshtatshme.
- ♦ Të njohin praktikatat e referimit dhe të atribuimit.
- ♦ Të marrin pjesë në shoqëri përmes përdorimit të shërbimeve digjitale publike dhe private.
- ♦ Të kërkojnë mundësi për vetë-fuqizim dhe për qytetari pjesëmarrëse përmes teknologjive digjitale të përshtatshme.
- ♦ Të përdorin teknologji digjitale për proceset bashkëpunuese, si dhe për bashkë-ndërtimin dhe bashkë-krijimin e resurseve dhe të dijes.
- ♦ Të jenë të vetëdijshëm për normat e sjelljes dhe aftësitë praktike gjatë përdorimit të teknologjive digjitale dhe ndërveprimit në mjedise digjitale.
- ♦ Të përshtatin strategjitë e komunikimit me audiencën specifike dhe të jenë të vetëdijshëm për diversitetin kulturor dhe brezor në mjedise digjitale.
- ♦ Të krijojnë dhe të menaxhojnë një ose më shumë identitete digjitale.
- ♦ Të mbrojnë reputacionin e vet.
- ♦ Të menaxhojnë të dhënat që prodhojnë përmes teknologjive, mjediseve dhe shërbimeve të ndryshme digjitale.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i strategjive për nxitjen e komunikimit dhe bashkëpunimit digjital të nxënësit.	Unë nuk marr parasysh, ose marr parasysh vetëm shumë rrallë, mënyra se si mund të nxis komunikimin dhe bashkëpunimin digjital të nxënësit.
Eksplorues (A2) 	Inkurajim i nxënësve që të përdorin teknologji digjitale për komunikim dhe bashkëpunim.	Unë i inkurajoj nxënësit të përdorin teknologji digjitale për të ndërvepruar me nxënës të tjerë, me edukatorët e tyre, me stafin menaxhues dhe me palë të treta.
Integrues (B1) 	Implementim i aktiviteteve që nxisin komunikimin dhe bashkëpunimin digjital të nxënësve.	Unë implementoj aktivitete të mësimnxënies në të cilat nxënësit përdorin teknologjitë digjitale për komunikim. Unë udhëzoj nxënësit të respektojnë normat e sjelljes, të përzgjedhin në mënyrë të përshtatshme strategjitë dhe kanalet e komunikimit, si dhe të jenë të vetëdijshëm për diversitetin kulturor dhe shoqëror në mjedise digjitale.
Ekspert (B2) 	Përdorim në mënyrë strategjike i një game të gjerë strategjish pedagogjike që nxisin komunikimin dhe bashkëpunimin digjital të nxënësve.	Unë përdor një gamë strategjish të ndryshme pedagogjike në të cilat nxënësit përdorin teknologjitë digjitale për komunikim dhe bashkëpunim. Unë mbështes dhe inkurajoj nxënësit të përdorin teknologjitë digjitale për të marrë pjesë në diskutet publike dhe për t'i përdorur ato në mënyrë aktive dhe të ndërgjegjshme për pjesëmarrje qytetare.
Udhëheqës (C1) 	Nxitje gjithëpërfshirëse dhe kritike e komunikimit dhe bashkëpunimit digjital të nxënësve.	Unë përfshij detyra dhe aktivitete vlerësimi që kërkojnë nga nxënësit të përdorin teknologjitë digjitale në mënyrë efektive dhe me përgjegjësi për komunikim, bashkëpunim bashkë-krijim dhe pjesëmarrje qytetare. Unë reflektoj në mënyrë kritike mbi përshtatshmërinë e strategjive të mia pedagogjike për nxitjen e komunikimit dhe bashkëpunimit digjital të nxënësit dhe përshtat strategjitë e mia në përputhje me këtë.
Pionier (C2) 	Përdorim i formateve novatore që nxisin komunikimin dhe bashkëpunimin digjital të nxënësve.	Unë reflektoj, diskutoj, ri-projektoj dhe sjell novacion në strategjitë pedagogjike për nxitjen e komunikimit dhe bashkëpunimit të nxënësit.



Krijimi i përmbajtjes digjitale

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të shprehen përmes mjeteve digjitale dhe të modifikojnë dhe krijojnë përmbajtje digjitale në formate të ndryshme. Të mësohen nxënësit se si aplikohen të drejtat e autorit dhe licencat për përmbajtjen digjitale, si të referojnë burimet dhe si të atribuojnë licencat.

Aktivitete

Të përfshihen aktivitete të mësimnxënies, detyra dhe vlerësime të cilat nxisin dhe kërkojnë nga nxënësit:

- ♦ Të krijojnë dhe të redaktojnë përmbajtje digjitale në formate të ndryshme.
- ♦ Të shprehen përmes mjeteve digjitale.
- ♦ Të modifikojnë, përmirësojnë, rafinojnë dhe të integrojnë informacionin dhe përmbajtjen në një trup ekzistues të dijes.
- ♦ Të krijojnë përmbajtje dhe dije të re, origjinale dhe përkatëse.
- ♦ Të kuptojnë se si aplikohen të drejtat e autorit dhe licencat për të dhëna, informacion dhe përmbajtje digjitale.
- ♦ Të planifikojnë dhe zhvillojnë një sekuencë udhëzimesh të kuptueshme për një sistem kompjuterik për të zgjidhur një problem të caktuar ose për të kryer një detyrë specifike.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i strategjive për nxitjen e krijimit të përmbajtjes digjitale nga nxënësit.	Unë nuk marr parasysh, ose marr parasysh vetëm shumë rrallë, mënyra se si mund të nxitet krijimi i përmbajtjes digjitale nga nxënësit mësimdhënie.
Eksplorues (A2) 	Inkurajim i nxënësve që të përdorin teknologji digjitale për krijimin e përmbajtjes.	Unë inkurajoj nxënësit të shprehen duke përdorur teknologji digjitale, p.sh. duke prodhuar tekste, imazhe ose video.
Integrues (B1) 	Implementim i aktiviteteve që nxisin krijimin e përmbajtjes digjitale nga nxënësit.	Unë implementoj aktivitete të mësimnxënies në të cilat nxënësit përdorin teknologji digjitale për të prodhuar përmbajtje digjitale, p.sh. në formën e tekstit, fotografive, imazheve të tjera, videove, etj. Unë inkurajoj nxënësit të publikojnë dhe të ndajnë prodhimet e tyre digjitale.
Ekspert (B2) 	Përdorim në mënyrë strategjike i një game të gjerë strategjish pedagogjike që nxisin krijimin e përmbajtjes digjitale nga nxënësit.	Unë përdor një gamë strategjish të ndryshme pedagogjike për t'u mundësuar nxënësve të shprehen në mënyrë digjitale, p.sh. duke kontribuar në platforma tipi wiki ose tipi blog, ose duke përdorur ePortofolio për krijimet e tyre digjitale. Unë u mundësoj nxënësve të kuptojnë konceptin e të drejtave të autorit dhe të licencave dhe si të ri-përdorin përmbajtjen digjitale në mënyrë të përshtatshme.
Udhëheqës (C1) 	Nxitje gjithëpërfshirëse dhe kritike e krijimit të përmbajtjes digjitale nga nxënësit.	Unë detektoj dhe parandaloj plagjiaturën, p.sh. duke përdorur teknologji digjitale. Unë reflektoj në mënyrë kritike mbi përshtatshmërinë e strategjive të mia pedagogjike për nxitjen e shprehjes kreative digjitale të nxënësve dhe i përshtat strategjitë e mia në përputhje me këtë.
Pionier (C2) 	Përdorim i formateve novatore që nxisin krijimin e përmbajtjes digjitale nga nxënësit.	Unë udhëzoj nxënësit në projektimin, publikimin dhe licencimin e produkteve komplekse digjitale, p.sh. krijimin e uebsajteve, platformave tip blog, lojërave ose aplikacioneve. Unë reflektoj, diskutoj, ri-projektoj dhe sjell



Përdorimi me përgjegjësi

Të merren masa për të siguruar mirëqenien fizike, psikologjike dhe sociale të nxënësve gjatë përdorimit të teknologjive digjitale. Të fuqizohen nxënësit për të menaxhuar risqet dhe për të përdorur teknologjitë digjitale në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi.

Aktivitete

Të përçohet të nxënësit një qëndrim pozitiv ndaj teknologjive digjitale, duke nxitur përdorimin e tyre në mënyrë kreative dhe kritike.

Të mundësohet që nxënësit:


- Të mbrojnë pajisjet dhe përmbajtjen digjitale, si dhe të kuptojnë rreziqet dhe kërcënimet në mjedise digjitale.
- Të kuptojnë masat e sigurisë dhe mbrojtjes në përdorimin e teknologjive digjitale.
- Të mbrojnë të dhënat personale dhe privatësinë në mjedise digjitale.
- Të kuptojnë si të përdorin dhe ndajnë informacionin personal duke qenë në gjendje të mbrojnë veten dhe të tjerët nga dëmet.
- Të kuptojnë se shërbimet digjitale përdorin një "Politikë privatësie" mbi mënyrën e përdorimit të të dhënave personale.

- Të shmangin rreziqet për shëndetin dhe kërcënimet ndaj mirëqenies fizike dhe psikologjike gjatë përdorimit të teknologjive digjitale.
- Të mbrojnë veten dhe të tjerët nga rreziqet e mundshme në mjedise digjitale (p.sh. bullizmi kibernetik).
- Të jenë të vetëdijshëm për përdorimin e teknologjive digjitale për mirëqenie sociale dhe përfshirje sociale.
- Të jenë të vetëdijshëm për ndikimin mjedisor të teknologjive digjitale dhe përdorimit të tyre.

Të monitorojnë sjelljen e nxënësve në mjedise digjitale për të mbrojtur mirëqenien e tyre.

Të reagojnë menjëherë dhe në mënyrë efektive kur kërcënohet mirëqenia e nxënësve në mjedise digjitale (p.sh. bullizmi kibernetik).

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i strategjive për nxitjen e mirëqenies digjitale te nxënësit.	Unë jam i vetëdijshëm se teknologjitë digjitale mund të ndikojnë pozitivisht dhe negativisht në mirëqenien e nxënësve.
Eksplorues (A2) 	Inkurajim i nxënësve për të përdorur teknologjitë digjitale në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi.	Unë kultivoj vetëdijen e nxënësve mbi mënyrën se si teknologjitë digjitale mund të ndikojnë pozitivisht dhe negativisht në shëndetin dhe mirëqenien e tyre, p.sh. duke i inkurajuar të identifikojnë sjellje (të tyre ose të tjerëve) që i bëjnë të ndihen të lumtur ose të trishtuar. Unë kultivoj vetëdijen e nxënësve mbi përfitimet dhe kufizimet e internetit të hapur.
Integruues (B1) 	Implementim i masave për të siguruar mirëqenien e nxënësve.	Unë jap këshilla praktike dhe bazuar në përvojë mbi mënyrat për të mbrojtur privatësinë dhe të dhënat, p.sh. duke përdorur fjalëkalime dhe duke rregulluar cilësimet e rrjeteve sociale. Unë ndihmoj nxënësit lidhur me mbrojtjen e identitetit digjital dhe menaxhimin e gjurmëve të tyre digjitale. Unë këshilloj nxënësit mbi masat efektive për të kufizuar ose për t'i kundërvënë ndikimit të sjelljeve të papërshtatshme (të tyre ose të shokëve të tyre).
Ekspert (B2) 	Mbështetje pedagogjike e përdorimit të teknologjive digjitale për të siguruar mirëqenien e nxënësve.	Unë zhvilloj strategji për të parandaluar, identifikuar dhe reaguar ndaj sjelljeve digjitale që ndikojnë negativisht në shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve (p.sh. bullizmi kibernetik). Unë inkurajoj nxënësit të marrin një qëndrim pozitiv ndaj teknologjive digjitale, duke qenë të vetëdijshëm për rreziqet dhe kufizimet e mundshme, por edhe duke pasur besim se mund t'i menaxhojnë këto për të përfituar nga avantazhet.
Udhëheqës (C1) 	Zhvillim strategjik dhe kritik i përdorimit të sigurt dhe me përgjegjësi të teknologjive digjitale nga nxënësit.	Unë mundësoj që nxënësit të kuptojnë rreziqet dhe kërcënimet në mjedise digjitale (p.sh. vjedhja e identitetit, mashtrimet, përndjekja, sulmet e synuara kibernetike apo phishing) dhe mënyrën e reagimit të përshtatshëm. Unë reflektoj në mënyrë kritike mbi përshtatshmërinë e strategjive të mia pedagogjike për nxitjen e mirëqenies digjitale të nxënësve dhe përshtat strategjitë e mia në përputhje me këtë.
Pionier (C2) 	Zhvillim i qasjeve novatore në mënyrë që të nxitet aftësia e nxënësve për të përdorur teknologjitë digjitale për mirëqenien e tyre.	Unë reflektoj, diskutoj, ri-projektoj dhe sjell novacion në strategjitë pedagogjike për të nxitur aftësinë e nxënësve për të përdorur teknologjitë digjitale për mirëqenien e tyre.



Zgjidhja digjitale e problemeve

Të përfshihen aktivitete mësimore, detyra dhe vlerësime që kërkojnë nga nxënësit të identifikojnë dhe zgjidhin probleme teknike, ose të transferojnë në mënyrë kreative njohuritë teknologjike në situata të reja.

Aktivitete

Të përfshihen aktivitete të mësimnxënies, detyra dhe vlerësime të cilat nxisin dhe kërkojnë nga nxënësit:

- ♦ Të identifikojnë problemet teknike gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjediseve digjitale dhe të gjejnë zgjidhje për to.
- ♦ Të rregullojnë dhe personalizojnë mjediset digjitale sipas nevojave të veta.
- ♦ Të identifikojnë, vlerësojnë, përzgjedhin dhe përdorin teknologjitë digjitale dhe mundësitë teknologjike për të zgjidhur një detyrë ose problem të caktuar.
- Të përdorin teknologji digjitale në mënyra novatore për krijimin e dijes.
- Të kuptojnë ku duhet të përmirësojnë ose azhurnojnë kompetencën e tyre digjitale.
- Të mbështesin të tjerët në zhvillimin e kompetencës digjitale.
- Të kërkojnë mundësi për zhvillim personal dhe të mbeten në hap me evolucionin digjital.

Progresioni		Deklaratat e zotësisë digjitale
Fillestar (A1) 	Përdorim i pakët i strategjive për nxitjen e zgjidhjes digjitale të problemeve nga nxënësit.	Unë nuk marr parasysh, ose marr parasysh vetëm shumë rrallë, mënyra se si mund të nxitet zgjidhja digjitale e problemeve nga nxënësit.
Eksplorues (A2) 	Inkurajim i nxënësve që të përdorin teknologjitë digjitale për zgjidhjen e problemeve.	Unë inkurajoj nxënësit të zgjidhin problemet teknike përmes metodës së provës dhe gabimit. Unë inkurajoj nxënësit të transferojnë kompetencën e tyre digjitale në situata të reja.
Integruues (B1) 	Implementim i aktiviteteve që nxisin zgjidhjen digjitale të problemeve nga nxënësit.	Unë implementoj aktivitete të mësimnxënies në të cilat nxënësit përdorin teknologji digjitale në mënyrë kreative, duke zgjeruar repertorin e tyre teknik. Unë inkurajoj nxënësit të ndihmojnë njëri-tjetrin në zhvillimin e kompetencës digjitale.
Ekspert (B2) 	Përdorim në mënyrë strategjike i një game të gjerë strategjish pedagogjike që nxisin zgjidhjen digjitale të problemeve nga nxënësit.	Unë përdor një gamë strategjish të ndryshme pedagogjike për t'u mundësuar nxënësve të aplikojnë kompetencën e tyre digjitale në situata të reja ose në kontekste të ndryshme. Unë inkurajoj nxënësit të reflektojnë mbi kufijtë e kompetencës së tyre digjitale dhe u ndihmoj të identifikojnë strategjitë e përshtatshme për zhvillimin e mëtejshëm të saj.
Udhëheqës (C1) 	Nxitje gjithëpërfshirëse dhe kritike e zgjidhjes digjitale të problemeve nga nxënësit.	Unë mundësoj që nxënësit të kërkojnë zgjidhje teknologjike të ndryshme për një problem, të shqyrtojnë përfitimet dhe kufizimet e tyre dhe të arrijnë në mënyrë kritike dhe kreative të një zgjidhje ose produkt të ri. Unë reflektoj në mënyrë kritike mbi përshtatshmërinë e strategjive të mia pedagogjike për të nxitur kompetencën digjitale të nxënësve dhe zgjerimin e repertorit të tyre të strategjive digjitale, dhe përshtat metodat e mia në përputhje me këtë.
Pionier (C2) 	Përdorim i formateve novatore për nxitjen e zgjidhjes digjitale të problemeve nga nxënësit.	Unë mundësoj që nxënësit të aplikojnë kompetencën e tyre digjitale në mënyra jo-konvencionale në situata të reja dhe të arrijnë në mënyrë kreative të zgjidhje ose produkte të reja. Unë reflektoj, diskutoj, ri-projektoj dhe sjell novacion në strategjitë pedagogjike për nxitjen e aftësive të zgjidhjes digjitale të problemeve nga nxënësit.

Fjalorth termash




FIGURA 6: PASQYRË E KONCEPTVE KRYESORE QË PËRDOREN NË KORNIZËN DIGCOMPEDU

ACCEPTABLE USAGE POLICY (AUP) / POLITIKË E PËRDORIMIT TË PRANUESHËM

Politika e Përdorimit të Pranueshëm është një dokument që përcakton një grup rregullash që duhet të respektohen nga përdoruesit ose klientët e një tërësie resursesh kompjuterike, të cilat mund të jenë një rrjet kompjuterik, një uebsajt ose një sistem i madh kompjuterik.

Një AUP përcakton në mënyrë të qartë se çfarë lejohet dhe çfarë nuk lejohet të bëjë përdoruesi me këto resurse.

Burimi: <https://www.techopedia.com/definition/2471/acceptable-use-policy-aup>

ASSISTIVE TECHNOLOGY (AT) / TEKNOLOGJI NDIHMUESE

Teknologjia ndihmuese është një term i përgjithshëm që përdoret për të përshkruar një grup pajisjesh softuerike ose harduerike, përmes të cilave personat me aftësi të kufizuara mund të kenë qasje në kompjuterë. Ato mund të jenë pajisje të zhvilluara dhe të tregtuara posaçërisht ose produkte të gatshme që janë modifikuar. Teknologjia ndihmuese mund të përfshijë pajisje si tastiera dhe minj alternative, softuer për njohjen e zërit, softuer për zmadhimin e ekranit, joystick me shumë çelësa, dhe ndihmë për komunikim nga teksti në të folur.

Burim: <http://www.webopedia.com>

CONTINUOUS PROFESSIONAL DEVELOPMENT (CPD) / ZHVILLIM I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (ZHVP)

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është mënyra përmes së cilës anëtarët e profesioneve ruajnë, përmirësojnë dhe zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe zhvillojnë cilësitë personale të nevojshme në jetën e tyre profesionale, zakonisht përmes një game programesh trajnimi të shkurtra dhe të gjata, disa prej të cilave ofrojnë akreditim. Ky arsimim dhe aftësim i vazhdueshëm, i lidhur me punën, u referohet të gjitha aktiviteteve të organizuara dhe sistematike të arsimit dhe aftësimit, në të cilat individët marrin pjesë për të përvetësuar njohuri dhe/ose për të mësuar aftësi të reja për një punë aktuale ose të ardhshme.

Përshtatur nga <http://www.umultirank.org/#!/glossary?trackType=home&sightMode=undefined§ion=undefined>

Përshtatur nga <http://creativecommons.org/about>

DATA / TË DHËNA

Sekuenca prej një ose më shumë simboleve të cilës i jepet kuptim përmes aktit ose akteve specifike të interpretimit. Të dhënat, si koncept i përgjithshëm, i referohen faktit se disa informacione ose njohuri ekzistuese përfaqësohen ose kodohen në një formë të përshtatshme për përdorim ose përpunim më të mirë. Të dhënat maten, mbledhen, raportohen dhe analizohen, dhe më pas mund të vizualizohen duke përdorur grafikë, imazhe ose mjete të tjera analizimi (Wikipedia).

DIGITAL COMMUNICATION / KOMUNIKIM DIGITAL

Komunikimi përmes teknologjisë digjitale. Ekzistojnë mënyra të ndryshme të komunikimit, p.sh. komunikimi sinkron (komunikim në kohë reale, p.sh. përdorimi i Skype, video chat ose Bluetooth) dhe komunikimi asinkron (komunikim jo i njëkohshëm, p.sh. email, SMS), duke përdorur për shembull mënyra një-me-një, një-me-shumë, ose shumë-me-shumë.

DIGITAL COMPETENCE / KOMPETENCË DIGJITALE

Kompetenca digjitale mund të përkufizohet në mënyrë të gjerë si përdorimi i sigurt, kritik dhe kreativ i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) për të arritur qëllime që lidhen me punën, punësueshmërinë, mësimnxënien, kohën e lirë, përfshirjen dhe/ose pjesëmarrjen në shoqëri.

Burimi: *DigComp Framework* <https://ec.europa.eu/jrc/digcomp>

DIGITAL CONTENT / PËRMBAJTJE DIGJITALE

Çdo lloj përmbajtjeje që ekziston në formë të të dhënave digjitale të koduara në një format të lexueshëm nga makina, dhe që mund të krijohet, shikohet, shpërndahet, modifikohet dhe ruhet duke përdorur teknologji digjitale. Shembuj të përmbajtjes digjitale përfshijnë: uebfaqe dhe uebsajte, media sociale, të dhëna dhe baza të dhënash, audio digjitale si mp3, libra elektronike (e-book), imazhe digjitale, video digjitale, lojëra kompjuterike, programe kompjuterike dhe softuer. Sipas Kornizës DigCompEdu, përmbajtja digjitale ndahet në resurse digjitale dhe të dhëna.

DIGITAL ENVIRONMENT / MJEDIS DIGJITAL

Kontekst, ose “vend”, i mundësuar nga teknologjia dhe pajisjet digjitale, shpesh i transmetuar përmes internetit ose mjeteve të tjera digjitale, p.sh. rrjeti i telefonisë mobile. Mjediset digjitale zakonisht përdoren për ndërveprim me përdorues të tjerë dhe për qasje në përmbajtje të krijuar nga përdoruesit dhe publikim të saj. Regjistrimet dhe dëshmitë e ndërveprimit të një individi me një mjedis digjital përbëjnë *gjurmën digjitale* (digital footprint) të atij individi.

DIGITAL RESOURCES / RESURSE DIGJITALE

Ky term zakonisht i referohet çdo përmbajtjeje të publikuar në një format të lexueshëm nga kompjuteri. Për qëllimet e Kornizës DigCompEdu, bëhet dallim midis resurseve digjitale dhe të dhënave. Resurset digjitale përfshijnë çdo lloj përmbajtjeje digjitale që është menjëherë e kuptueshme për përdoruesin-njeri, ndërsa të dhënat duhet të analizohen, të përpunohen dhe/ose të interpretohen për të qenë të dobishme për edukatorët.

DIGITAL SERVICES / SHËRBIME DIGJITALE

Shërbime që mund të ofrohen përmes komunikimit digjital, p.sh. interneti, rrjeti i telefonisë mobile, të cilat mund të përfshijnë ofrimin e informacionit digjital (p.sh. të dhëna, përmbajtje) dhe/ose shërbime transaksionale. Ato mund të jenë publike ose private, p.sh. e-qeverisje, shërbime bankare digjitale, e-tregti, shërbime muzike (p.sh. Spotify), shërbime filmi/TV (p.sh. Netflix).

DIGITAL TECHNOLOGY / TEKNOLOGJI DIGJITALE

Çdo produkt ose shërbim që mund të përdoret për të krijuar, shikuar, shpërndarë, modifikuar, ruajtur, nxjerrë, transmetuar dhe marrë informacion në formë digjitale. Në këtë kornizë, termi “teknologji digjitale” përdoret si koncepti më i përgjithshëm, duke përfshirë:

- rrjetet kompjuterike (p.sh. interneti) dhe çdo shërbim online të mbështetur nga këto (p.sh. uebsajte, rrjete sociale, biblioteka online, etj.),
- çdo lloj softueri (p.sh. programe, aplikacione, mjedise virtuale, lojëra), qoftë i lidhur në internet ose i instaluar në rrjet lokal,
- çdo lloj hardueri ose “pajisjeje” (p.sh. kompjuterë personale, pajisje mobile, tabela digjitale), dhe
- çdo lloj përmbajtjeje digjitale, p.sh. skedarë, informacion, të dhëna.

Për qëllimet e kornizës DigCompEdu, kategoria e teknologjive digjitale ndahet në këto fusha: pajisje digjitale; resurse digjitale (= skedarë digjitalë + softuer + shërbime online); të dhëna.

DIGITAL TOOLS / MJETE DIGJITALE

Teknologji digjitale të përdorura për një qëllim të caktuar ose për kryerjen e një funksioni specifik, p.sh. për përpunimin e informacionit, komunikim, krijimin e përmbajtjes, siguri ose zgjidhjen e problemeve.

EDUCATIONAL CONTENT / PËRMBAJTJE ARSIMORE

Përmbajtje (digjitale) që lidhet, në një mënyrë ose tjetër, me kontekstin arsimor. Ky term është më i gjerë sesa termi “resurs arsimor”, pasi përfshin edhe përmbajtje që është marginale ndaj procesit mësimor, p.sh. komunikimi me nxënësit, prindërit, kolegët; përmbajtje administrative, etj.

EDUCATIONAL RESOURCES / RESURSE ARSIMORE

Resurse (digjitale ose jo) të projektuara dhe të destinuar për t'u përdorur për qëllime arsimore.

EDUKATOR

Në kontekstin e kornizës DigCompEdu, termi “edukator” përdoret në mënyrë të përgjithshme për të përshkruar çdo person të përfshirë në procesin e mësimdhënies ose transmetimit të njohurive. Në veçanti, u referohet mësimdhënësve në të gjitha nivelet e arsimit formal, që nga niveli parashkollor, arsimit fillor dhe i mesëm, deri te arsimit i mëtejshëm dhe i lartë (p.sh. ligjëruesit universitarë), arsimit profesional dhe arsimit i të rriturve, duke përfshirë aftësimin fillestar dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Për analogji, mund të përdoret gjithashtu për të përshkruar personat e përfshirë në ofrimin e trajnimeve në mjedis joformale dhe informale, p.sh. punonjës socialë, staf bibliotekë, prindër që ofrojnë shkollim për fëmijët e tyre në shtëpi, etj.

E-PORTFOLIOS / E-PORTFOLIO

Koleksione punimesh (të nxënësve) që mund të avancojnë mësimnxënien duke u ofruar mënyrë për të organizuar, arkivuar, ekspozuar dhe reflektuar mbi punën e tyre. E-portfoliot janë si demonstrime të aftësive të përdoruesve, ashtu edhe platforma për vetë-shprehje.

FORMATIVE ASSESSMENT / VLERËSIM FORMATIV

Vlerësimi formativ i referohet një game të gjerë metodash që përdorin mësimdhënësit për të kryer vlerësime gjatë procesit mbi kuptimin, nevojat për mësimnxënie dhe përpunimin akademik të nxënësve gjatë një mësimi, njësie ose kursi. Qëllimi i përgjithshëm i vlerësimit formativ është mbledhja e informacionit të detajuar që mund të përdoret për përmirësimin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies së nxënësve ndërkohë që ajo po zhvillohet.

Burimi: Glossary of Education Reform <http://edglossary.org/formative-assessment/>

LEARNING ANALYTICS / ANALITIKË E MËSIMNXËNIES

Analitika e mësimnxënies është matja, mbledhja, analiza dhe raportimi i të dhënave mbi nxënësit dhe kontekstet e tyre, me qëllim kuptimin dhe optimizimin e mësimnxënies dhe të mjediseve ku ajo zhvillohet.

Burimi: Përkufizim i adoptuar në Konferencën e Parë Ndërkombëtare mbi Analitikën e Mësimnxënies. http://edutechwiki.unige.ch/en/Learning_analytics

LEARNING OUTCOMES / REZULTATE TË MËSIMNXËNIES

Rezultatet e mësimnxënies përkufizohen si njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që individët kanë përvetësuar si rezultat

i mësimnxënies dhe që mund të demonstrohen, nëse është e nevojshme, në një proces njohjeje. Sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF), rezultatet e mësimnxënies janë deklarata të asaj që një nxënës di, kupton dhe është i aftë të bëjë pas përfundimit të një procesi mësimor.

Burimi: http://www.eucen.eu/sites/default/files/OECD_RNFIFL2010_Werquin.pdf

OPEN EDUCATIONAL RESOURCES / RESURSE ARSIMORE TË HAPURA

Materiale mësimdhënieje, mësimnxënieje dhe kërkimore në çdo medium, digjital ose jo, që janë në domen publik ose janë botuar nën një licencë të hapur që lejon qasje, përdorim, adaptim dhe ri-shpërndarje nga të tjerët, pa kosto, me kufizime të pakta ose pa kufizime.

Burimi: Përkufizim sipas UNESCO <http://www.unesco.org/new/en/communication-and-information/access-to-knowledge/open-educational-resources/what-are-open-educational-resources-oers/>

PEER-ASSESSMENT / VLERËSIM NGA BASHKËMOSHATARËT APO VLERËSIM NGA NJËRI-TJETRI

Vlerësimi nga bashkëmoshatarët apo nga njëri-tjetri është proces ku nxënësit vlerësojnë detyrat ose testet e njëri-tjetrit, bazuar në kritere të vendosura nga mësimdhënësi. Kjo praktikë përdoret për të kursyer kohën e mësimdhënësve, për të përmirësuar kuptimin e nxënësve mbi materialet e kursit dhe për të zhvilluar aftësitë meta-njohëse të tyre. Vlerësimi nga njëri-tjetri mund të fuqizojë nxënësit të marrin përgjegjësi për mësimnxënien e tyre; t'u mundësojë të mësojnë të vlerësojnë dhe të zhvillojnë aftësi vlerësimi gjatë gjithë jetës; të përmirësojë mësimnxënien përmes shpërndarjes së njohurive dhe shkëmbimit të ideve; dhe të motivojë nxënësit të angazhohen më thellë me materialin e kursit.

Burimi: Përshtatur nga Wikipedia; Cornell University Centre for Teaching Excellence, <http://www.cte.cornell.edu/>

SELF-ASSESSMENT / VETË-VLERËSIM

Vetë-vlerësimi përfshin aftësinë për të qenë një gjyqtar realist i performancës vetjake. Proponentët e vetë-vlerësimit sugjerojnë se ka shumë përfitime, p.sh.: ofron informacion kthyes (feedback) me kohë dhe efektiv; mundëson që nxënësit të vlerësojnë shpejt mësimnxënien e tyre; ndihmon mësimdhënësit të kuptojnë dhe të japin feedback të shpejtë mbi të nxënësit; promovon integritetin akademik përmes raportimit të progresit nga nxënësit; nxit aftësitë e praktikës reflektuese dhe vetë-monitorimit; zhvillon mësimnxënie të vetë-rregulluar; rrit motivimin e nxënësve; përmirëson

kënaqshmërinë falë pjesëmarrjes në një mjedis mësimnxënies në mënyrë bashkëpunuese; ndihmon nxënësit të zhvillojnë një gamë aftësish personale dhe të transferueshme për të përmbushur pritshmëritë e punëdhënësve të ardhshëm.

Burimi: *Cornell University Centre for Teaching Excellence*
<http://www.cte.cornell.edu/>

SELF-ASSESSMENT TOOL / MJET VETË-VLERËSIMI

Mjet vetë-vlerësimi është instrumenti që ndihmon profesionistët të vlerësojnë vetveten, d.m.th. vlerësimin e efektivitetit të performancës së tyre në të gjitha fushat e përgjegjësisë dhe përcaktimin e përmirësimeve të nevojshme (Përshtatur nga: <http://www.businessdictionary.com/definition/self-assessment.html>). Në këtë raport, termi përdoret për t'iu referuar programeve online në formën e pyetësorëve që lejojnë mësimdhënësit të vlerësojnë kompetencën e tyre digjitale me ndihmën e një grupi pyetjesh. Zakonisht ofrohet informacion kthyes (feedback) në formën e një raporti, duke identifikuar pikat e forta dhe fushat për zhvillim.

SELF-DETERMINED LEARNING / MËSIMNXËNIE E VETË-PËRCAKTUAR

“Proces në të cilin nxënësit marrin iniciativën për të identifikuar nevojat e tyre për mësimnxënien, për të formuluar objektivat e mësimnxënies, për të identifikuar resurset e mësimnxënies, për të implementuar strategji për zgjidhje të problemeve dhe për të reflektuar mbi proceset e të nxënit duke sfiduar supozimet ekzistuese dhe duke rritur aftësitë e të nxënit.” (Blaschke, 2012; <http://www.rtschuetz.net/2014/12/self-directed-vs-self-determined.html>). Ky koncept lidhet me konceptet e mësimin të vetë-drejtuar (self-directed) dhe të vetë-rregulluar (self-regulated). Nga këta tre, ai kërkon nivelin më të lartë të autonomisë së nxënësit. Për shkak se një nivel kaq i lartë autonomie mund të jetë tepër ambicioz për disa kontekste mësimore ose grupe nxënësish, në kornizën DigCompEdu i jepet përparësi konceptit të mësimin të vetë-rregulluar.

SELF-DIRECTED LEARNING / MËSIMNXËNIE E VETË-DREJTUAR

Ky term “procesin në të cilin individët marrin iniciativën, me ose pa ndihmën e të tjerëve, për të diagnostikuar nevojat e tyre për mësimnxënien, për të formuluar objektivat e mësimnxënies, për të identifikuar resurse njerëzore dhe materiale për mësimnxënien, për të zgjedhur dhe implementuar strategjitë e duhura të mësimnxënies, dhe për të vlerësuar rezultatet e mësimnxënies.” (Knowles, 1975, f. 18; <http://infed.org/mobi/self-directed-learning/>). Ky koncept lidhet me konceptet e mësimin të vetë-rregulluar (self-regulated) dhe të vetë-përcaktuar (self-determined). Nga pikëpamja e autonomisë së nxënësit, mësimnxënien e vetë-rregulluar është më pak kërkuar, ndërsa mësimnxënien e vetë-përcaktuar është më kërkuar.

Për DigCompEdu, i jepet përparësi konceptit të mësimnxënies së vetë-rregulluar, pasi të dy të tjerët mund të jenë koncepte tepër ambicioze për disa kontekste ose grupe nxënësish.

SELF-REGULATED LEARNING / MËSIMNXËNIE E VETË-RREGULLUAR

I referohet mësimnxënies së udhëhequr nga aftësitë meta-njohëse (reflektimi mbi të menduarit e vet), veprimi strategjik (planifikimi, monitorimi dhe vlerësimi i përparimit personal kundrejt një standardi) dhe motivimi për të mësuar. Termi “e vetë-rregulluar” përshkruan procesin e marrjes së kontrollit dhe vlerësimit të të nxënit dhe sjelljes vetjake. (Wikipedia) Ky koncept lidhet me konceptet e mësimnxënies së vetë-drejtuar dhe të vetë-përcaktuar. Duke qenë se këta të fundit kërkojnë një shkallë më të lartë autonomie, jo të arritshme në të gjitha kontekstet edukative, për DigCompEdu i jepet përparësi konceptit të mësimnxënies së vetë-rregulluar.

TEACHER / MËSIMDHËNËS

Mësimdhënësi është personi që ofron arsimim për nxënësit në arsimin formal, d.m.th. brenda një institucioni arsimor. Duke qenë se termi shpesh përdoret vetëm për arsimin shkollor (ISCED I-3), për DigCompEdu përdoret termi më i gjerë “edukator”.

SUMMATIVE ASSESSMENT / VLERËSIM SUMATIV

Vlerësimet sumative përdoren për të vlerësuar mësimnxënërit e nxënësve, përvetësimin e aftësive dhe arritjet akademike në përfundim të një periudhe të përcaktuar mësimore – zakonisht në fund të një projekti, njësie, kursi, semestri, programi ose viti shkollor. Rezultatet e vlerësimit sumativ regjistrohen shpesh si pikë apo nota që më pas hyjnë në evidencën e përhershme akademike të nxënësit.

Burimi: *The Glossary of Education Reform*
<http://edglossary.org/summative-assessment/>

VIRTUAL LEARNING ENVIRONMENT (VLE) / MJEDIS VIRTUAL I MËSIMNXËNIES

Mjedi virtual i mësimnxënies është platformë e bazuar në ueb për aspektet digjitale të kurseve të studimit, zakonisht brenda institucioneve arsimore. Këto mjedise zakonisht: mundësojnë organizimin e pjesëmarrësve në gjenerata/breza, grupe dhe role; paraqesin resurse, aktivitete dhe ndërveprime brenda strukturës së kursit; ofrojnë faza të ndryshme të vlerësimit; raportojnë mbi pjesëmarrjen; dhe kanë njëfarë niveli integrimi me sistemet e tjera institucionale. (Wikipedia).

TABELA 9: FJALORTH I TERMAVE TEKNIKE QË PËRDOREN NË KORNIZËN DIGCOMPEDU

Lista e figurave

Figura 1: Korniza DigCompEdu	7
Figura 2: Ilustrim vizual i kornizës DigCompEdu	14
Figura 3: Pasqyrë e kornizës DigCompEdu	16
Figura 4: Sintezë e kornizës DigCompEdu	18
Figura 5: Modeli i progresionit	28
Figura 6: Pasqyrë e koncepteve kryesore që përdoren	87

Lista e tabelave

Tabela 1: Fusha 1 - Angazhimi profesional	18
Tabela 2: Fusha 2 - Resurset digjitale	19
Tabela 3: Fusha 3 - Mësimdhënia dhe mësimnxënia	19
Tabela 4: Fusha 4 - Vlerësimi digjital	20
Tabela 5: Fusha 5 – Fuqizimi i nxënësve	21
Tabela 6: Fusha 6 - Lehtësimi i zhvillimit të kompetencës digjitale të nxënësve	22
Tabela 7: Pasqyrë e kornizës DigCompEdu	23
Tabela 8: Fjalë kyç që përdoren për progresionin e zotësive në kornizën DigCompEdu	30
Tabela 9: Fjalorth i termave teknike që përdoren në kornizën DigCompEdu	88

**Europe Direct është shërbim që ju ndihmon të gjeni
përgjigjet në pyetjet tuaja rreth Bashkimit Evropian.**

**Numri pa pagesë (*):
00 800 6 7 8 9 10 11**

(*) Disa operatorë të telefonisë mobile nuk lejojnë qasje në numrat 00 800 ose këto thirrje mund të tarifohen.

Shumë informacion shtesë mbi Bashkimin Evropian është i disponueshëm në internet.

Qasja në këtë informacion mund të realizohet përmes serverit Europa

<http://europa.eu>.

SI TË MERRNI PUBLIKIME TË BE-së

Publikime falas:

- Publikimet tona janë të disponueshme në EU Bookshop (<http://bookshop.europa.eu>), ku mund të bëni një porosi tek agjenti i shitjes që preferoni.
- Zyra e Publikimeve ka një rrjet global të agentëve të shitjes.
- Ju mund të merrni të dhënat e tyre të kontaktit duke dërguar një fakx në: (352) 29 29-42758.

MISIONI I QENDRËS SË PËRBASHKËT KËRKIMORE (JRC)

Si shërbim shkencor dhe i njohurive i Komisionit Evropian, misioni i Qendrës së Përbashkët Kërkimore është të mbështesë politikat e BE-së me të dhëna të pavarura gjatë gjithë ciklit të politikave.



@EU_ScienceHub



EU Science Hub-Joint Research Centre Joint Research Centre



EU Science Hub



doi:10.2760/159770

ISBN 978-92-79-73494-6



Publications Office



EU Science Hub
ec.europa.eu/jrc